



# EASO

## Raport për procedurat e azilit për fëmijët

*Seria e udhëzuesve praktikë EASO*

2019





European Asylum Support Office

# EASO

## Raport për procedurat e azilit për fëmijët

*Seria e udhëzuesve praktikë EASO*

**2019**

SUPPORT IS OUR MISSION

Manuscript completed in May 2019.

Neither the European Asylum Support Office (EASO) nor any person acting on behalf of the EASO is responsible for the use that might be made of the following information.

Illustrations page 21 © iStock, 2019

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2019

PDF ISBN 978-92-9465-234-8 doi:10.2847/040396 BZ-03-18-530-SQ-N

© European Union, 2019

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

For any use or reproduction of photos or other material that is not under the EASO copyright, permission must be sought directly from the copyright holders.

# Përmbajtja

Lista e shkurtimeve.....	5
Hyrje dhe qëllimi.....	6
<b>Seksioni 1. Përkufizimet operacionale .....</b>	<b>8</b>
<b>Shqyrtimi dhe trajtimi i këtyre shifrave.....</b>	<b>8</b>
Fëmijët e shoqëruar .....	8
Fëmijë të pashoqëruar .....	10
Fëmijë të pashoqëruar me të rritur shoqërues (nuk janë përgjegjës për ta).....	14
<b>Seksioni 2. Interesat më të mira të fëmijës në procedurat e azilit.....</b>	<b>19</b>
<b>Proces për vlerësimin e BIC në procedurat e azilit.....</b>	<b>19</b>
Kur bëhet vlerësim i BIC .....	19
Aktorët që përfshihen në vlerësimin e BIC .....	20
Mjetet dhe mekanizmat për cilësinë .....	22
<b>Seksioni 3. Procedurat e azilit për fëmijët.....</b>	<b>24</b>
<b>Mekanizmi për identifikimin e nevojave procedurale të fëmijëve .....</b>	<b>24</b>
<b>Masat mbrojtëse procedurale për fëmijët .....</b>	<b>24</b>
Prioritizimi i ekzaminimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare .....	24
Procedurat kufitare dhe ato të përshpejtuara.....	25
Bërja dhe paraqitja e aplikimit nga ose në emër të fëmijës .....	25
Intervista personale .....	27
<b>Garanci procedurale shtesë dhe kushte të veçanta pranimi për fëmijët .....</b>	<b>32</b>
<b>Seksioni 4. Referimi .....</b>	<b>34</b>
<b>Referimi tek autoritetet e tjera .....</b>	<b>34</b>
<b>Procedurat nëse fëmija humb, ka shenja të trafikimit ose abuzimit, në rastet e aftësive të kufizuara, problemeve me shëndetin, shtatzëninë ose çështje të tjera.....</b>	<b>35</b>
<b>Seksioni 5. Specializimi dhe trajnimi i stafit .....</b>	<b>45</b>
<b>Trajnimi.....</b>	<b>45</b>
<b>Specializimi për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët .....</b>	<b>46</b>
<b>Rekomandimet .....</b>	<b>47</b>
<b>Përkufizimet operacionale .....</b>	<b>47</b>
Fëmijët e shoqëruar nga prindërit .....	47
Fëmijë të pashoqëruar .....	47
Fëmijë të ndarë.....	48
Fëmijë të martuar.....	48
Fëmijët që kanë fëmijët e tyre .....	49
Fëmijët që janë në rrezik ose që janë viktime të trafikimit.....	49
Fëmijët e humbur .....	49
Fëmijët LGBTI.....	50
Fëmijët me aftësi të kufizuara .....	50
Fëmijët me trauma ose shqetësime psikologjike .....	51
Rrezikshmëritë e shumta.....	51
<b>Interesat më të mira të fëmijës .....</b>	<b>52</b>

<b>Procedura e azilit .....</b>	<b>53</b>
Prioritizimi .....	54
Vlerësimi i rrezikshmërisë dhe identifikimi i nevojave të veçanta .....	54
Përfaqësimi.....	54
Sigurimi i informacionit .....	55
E drejta e fjalës .....	56
Procesi i vendimmarrjes .....	56
<b>Mekanizmi kombëtar i referimit .....</b>	<b>57</b>
<b>Stafi i kualifikuar .....</b>	<b>57</b>

## Lista e shkurtimeve

APD	Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (e riformuar)
AT	Austri
BE	Belgjikë
BG	Bullgari
CH	Zvicër
CoO	vendi i origjinës
CY	Qipro
DE	Gjermani
DK	Danimarkë
EASO	Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin
EE	Estoni
EL	Greqi
ES	Spanjë
FGM	gjymtimi gjenital i femrave/prerja e organeve
FI	Finlanda
FR	Francë
HU	Hungari
IE	Irlandë
ILF	interesat më të mira të fëmijës
IT	Itali
IVO	informacioni për vendin e origjinës
KDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989)
Komiteti CRC	Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
LT	Lituani
LV	Letoni
MN	Mbrojtje ndërkombëtare
MS	Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian
NIDOS	Fondacioni NIDOS (instituti i kujdesit për të miturit e pashoqëruar që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Holandë)
NL	Holandë
NO	Norvegji
PL	Poloni
RO	Rumani
SE	Suedi
SI	Slloveni
SK	Sllovaki
SMA	Agjencia Suedeze për Emigracionin
Shtetet e BE+	Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, plus Norvegjia dhe Zvicra
TUSLA	agjencia për Fëmijët dhe Familjet, Irlandë
THB	trafikimi i qenieve njerëzore
UAM	i mitur i pashoqëruar
UNHCR	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
VIL	vlerësimi i interesave më të mira

## Hyrje dhe qëllimi

Situata e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, të cilët vijnë në BE vazhdon të jetë një sfidë shumë e madhe për sistemet kombëtare të azilit. Shpesh, fëmijët vijnë në Evropë pasi kanë qenë viktimat të shfrytëzimit dhe abuzimit, të cilëve u është mohuar kujdesi prindëror ose të cilët gjenden në situata rreziku që i bën edhe më të prekshëm. Shumë autoritete hasin vështirësi të mëdha për të reaguar në lidhje me nevojat e tyre të veçanta, duke u siguruar mbrojtjen dhe trajtimin e përshtatshëm që duhet të kenë të gjithë fëmijët. Përveç kësaj, për shkak të ndryshimeve mes sistemeve kombëtare, fëmijët që gjenden në situata ose rrethana të ngjashme mund të trajtohen ose konsiderohen ndryshe në varësi të shtetit të BE+ ku ndodhen. Kjo shumëllojshmëri praktikash mund të shkaktojë pabarazi dhe mospërputhje të panevojshme në identifikimin dhe mbrojtjen e këtyre fëmijëve, duke penguar kështu objektivat e CEAS.

Në dritën e komunikimit nga [Komisioni për mbrojtjen e fëmijëve në emigrim](#)<sup>1</sup> dhe të misionit të EASO për të ndihmuar Shtetet Anëtare nëpërmjet përfundimit të bashkëpunimit praktik, identifikimit të praktikave të mira dhe integritit të çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët në procedurat e azilit, EASO ka nisur një konsultim në vitin 2017 për procedurat e azilit për fëmijët dhe ka verifikuar zbulimet në vitin 2018. Synimi ishte të mblidheshin praktikat dhe rregullat kombëtare në lidhje me procedurat e azilit për fëmijët. Qëllimi i këtij raporti është të identifikohen boshllëqet dhe fushat e praktikave të ndryshme në shtetet e BE+, të theksohen praktikat e mira që janë adoptuar dhe të jepen rekomandime të rëndësishme për të forcuar mbrojtjen e fëmijëve në territorin e BE-së.

## Shtrirja e raportit dhe metodologjia

Si rrjedhojë e këtij ushtrimi, EASO ka përgatitur këtë raport të bazuar në kontributet e dhëna nga 24 shtetet e BE+ (AT, BE, BG, CH, CY, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IE, IT, LT, LV, NL, NO, PL, RO, SE, SI dhe SK).

Raporti mbulon vetëm procedurat e azilit për fëmijët, dhe prandaj fazat paralele, si pranimi ose rrugët e tjera ligjore për fëmijët (për të marrë rezidencë ose leje qëndrimi në bazë të moshës së mitur) janë përtej shtrirjes së këtij raporti dhe prandaj nuk mbulohet këtu. Përgatitja e këtij raporti ka ndjekur një analizë të informacionit të dërguar nga shtetet e BE+ në vitin 2017 në lidhje me praktikën e tyre ekzistuese, legjisllacionin dhe dokumentet e politikës së tyre.

Zbulimet paraprake janë verifikuar në mars të vitit 2018 nga Pikat e Kontaktit të EASO para se të konsolidoheshin në versionin përfundimtar.

## Struktura

Raporti ndjek strukturën e konsultimit:

### Seksioni 1: Përkufizimet operacionale

Termet dhe përkufizimet e ndryshme janë analizuar dhe krahasuar në të gjitha shtetet e BE+. Ai përfshin shqyrtimin dhe trajtimin që u nënshtrohen kategoritë e ndryshme të fëmijëve në shtetet e ndryshme të BE+.

### Seksioni 2: Interesat më të mira të fëmijës në procedurat për azil

Në këtë seksion eksplorohet operacionalizimi i interesave më të mira të fëmijës në procedurën e azilit nga autoritetet kombëtare.

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, [Komunikimi në Parlamentin Evropian dhe Këshilli për mbrojtjen e fëmijëve në emigrim](#), 12 prill 2017, COM(2017) 211 përfundimtare.



### Seksioni 3: Procedurat e azilit për fëmijët

Kjo pjesë përmbledh masat mbrojtëse dhe kushtet e veçanta që u sigurohen fëmijëve në procedurën e azilit.

### Seksioni 4: Referimi

Ky seksion tregon mekanizmat ekzistues të referimit dhe rrethanat që do t'i aktivizonin ato.

### Seksioni 5: Specializimi dhe trajnimi i stafit

Ky seksion tregon me hollësi mjetet e ndryshme dhe trajnimin për të pajisur stafin që ka kontakt me fëmijët ose që merret me dosjet e fëmijëve me njohuri të veçanta.

### Rekomandimet

Një koleksion rekomandimesh në të cilat jepet drejtim se si të adresohen çështjet e ngritura në raport.

Përveç rekomandimeve, në raport gjenden disa kuti teksti me të mëposhtmet:

- Shembuj nga praktika: informacione të nxjerra nga raportet e bëra nga EASO.
- Shënime për terminologjinë: përkufizimet ligjore ose operacionale për të zhvilluar një botëkuptim të përbashkët për disa terma që përdoren.

#### ➤ Shënime për terminologjinë

“Procedura e azilit” është termi i preferuar për qëllimin e këtij botimi krahasuar me termin “procedura e mbrojtjes ndërkombëtare”. Kjo përputhet me terminologjinë e përdorur nga një instrument ligjor kryesor lidhur me këtë temë, Direktiva 2013/32/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 26 qershorit 2013 lidhur me procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (ndryshim), i quajtur nga këtu e tutje APD.


“Acquis” i azilit në BE i referohet grupit të mëposhtëm të instrumenteve ligjore të BE-së: Direktiva e Kushteve të Pranimet, ndryshim (RCD), Direktiva e Procedurave të Azilit, ndryshim (APD), Direktiva e Kualifikimit, ndryshim (QD), Direktiva e Mbrojtjes së Përkohshme (e paaktivizuar), Rregullorja e Dublinit III (Dublin III) dhe Rregullorja Eurodac, ndryshim (Eurodac).

# Seksioni 1. Përkufizimet operationale

## Shqyrtimi dhe trajtimi i këtyre shifrave

Shumica e shteteve të BE+ kanë një përkufizim ligjor ose operacional për termat **i fëmijë i shoqëruar** dhe **i pashoqëruar, kujdestar** dhe/ose **përfaqësues**, por jo për termat **fëmijë i ndarë** ose **i rritur shoqëruar**. Megjithatë, vetëm në disa raste, përkufizimi kombëtar ekzistues përputhet realisht me përkufizimet e përcaktuara në *acquis* të azilit në BE ose me përkufizimin e propozuar nga EASO.

Mungesa e termave dhe përkufizimeve të harmonizuara mund të çojë në trajtime ose shqyrtime të ndryshme të rasteve të ngjashme, siç ilustron në zbulimet e mëposhtme. Këto zbulime janë paraqitur me një fokus të veçantë të kategoritë e ndryshme të fëmijëve, ku të rriturit përkatës janë integruar si nënseksione:



## Fëmijët e shoqëruar

### ➤ Shënime për terminologjinë

Termi “fëmijë/i mitur i shoqëruar” nuk shfaqet i përkufizuar shprehimisht në *acquis* për azil në BE, por EASO propozon një përkufizim *a contrario* të termit fëmijë/i mitur i pashoqëruar duke u bazuar në *acquis* të azilit në BE:

Një fëmijë që vjen në territorin e Shteteve Anëtare i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga një i rritur që është përgjegjës për të, qoftë me ligj, qoftë sipas praktikës së Shtetit Anëtar në fjalë, dhe për sa kohë për të tregohet kujdes i efektshëm nga ky person.

Ky përkufizim përputhet me atë që përdoret në legjislacionin kombëtar të shteteve të BE+ (**HU, PL, SI**).

Shtatëmbëdhjetë shtete të BE+ (**BE, BG, CH, CY, DE, DK, EL, EE, FI, FR, IE, IT, LV, NL, NO, SE, SK**) kanë përkufizimin e tyre kombëtar për termin “fëmijë i shoqëruar”, ndërsa në katër shtete të BE+ (**AT, ES, LT, RO**) nuk ekziston përkufizim në sistemin ligjor kombëtar.

### Përgjegjës i rritur për fëmijën

Gjatë procesit të konsultimit, EASO nuk propozoi asnjë përkufizim për termin ‘i rritur përgjegjës për fëmijën’ pasi sipas instrumenteve ligjore të BE-së, ky term duhet të përkufizohet në nivelin kombëtar, sipas ligjit ose praktikës së Shtetit Anëtar (SHA) në fjalë.

Të gjitha shtetet e BE+ (**AT, BE, BG, CH, CY, DE<sup>2</sup>, DK, EE, EL, FI, FR, HU, IE, IT, LT, LV, NL, NO, PL, RO, SE, SI** dhe **SK**) i identifikojnë prindërit adoptues si persona të rritur përgjegjës për fëmijën.

Sipas gjetjeve, në disa shtete të BE+ (**AT, BG, CH, CY, EE, EL, FR, LT, PL, dhe SE**) një person me kujdestari ligjore mund të pranohet gjithashtu si i rritur përgjegjës për fëmijën. Në veçanti, në **EL** dhe **FR**, autoriteti prindëror duhet të caktohet nga një autoritet gjyqësor. Në **EE**, i rrituri përgjegjës duhet të vërtetohet para policisë, rojës kufitare ose shërbimit të sigurisë së brendshme të Estonisë të drejtën e kujdestarisë që të konsiderohet i tillë.

Pjesëtarët e familjes dhe të afërmit<sup>3</sup> mund të konsiderohen të rritur përgjegjës për fëmijën në **AT, CH, DK, FR, HU, IE, IT, SI, SK**. Në veçanti, në **SI**, një i afërm i fëmijës që jeton në një komunitet, roli i të cilit është i ngjashëm me atë të familjes bazë ose ka të njëjtin funksion si familja, për shembull duke ofruar kujdes fizik, mbrojtje, ndihmë emocionale dhe varësi financiare, mund të konsiderohet përgjegjës për fëmijën.

Në 18 shtete të BE+ (**AT, BE, BG, CH, DE, EE, FI, FR, HU, IE, IT, LT<sup>4</sup>, LV, NL, NO<sup>5</sup>, RO, SE** dhe **SK**) kujdestari ligjor ose përfaqësuesi i caktuar mund të konsiderohet gjithashtu si person i rritur përgjegjës. Në **IT**, për shembull, kujdestari caktohet në rastet kur mungojnë prindërit ose të afërmit (deri në gradën e 4<sup>th</sup>) dhe prej tyre kërkohet që të kenë kompetencat e nevojshme dhe të kryejnë detyrimin e tyre sipas parimit të interesave më të mira të fëmijës (best interests of the child - BIC).

#### Shembuj nga praktika: të rritur përgjegjës

Në **DK**, të rriturit dhe persona të tjerë konsiderohen të rritur përgjegjës nëse Shërbimi Danez për Emigracionin i konsideron si kujdestarët përgjegjës në mungesë të prindërve. Do të bëhet një vlerësim për faktin nëse fëmija në fjalë duhet të konsiderohet apo jo i shoqëruar nga i rrituri. Vlerësimi bazohet në një intervistë si me fëmijën, ashtu edhe me të rriturin, dhe merren parasysh faktorët e mëposhtëm: fakti nëse pjesëtari i familjes e ka shoqëruar fëmijën rrugës për në DK, nëse kanë pasur kontakt në vendin e origjinës para se të largoheshin, dhe kontakti gjatë qëndrimit të tyre në DK, si edhe dëshirat e prindërve. Është gjithnjë kusht paraprak që shoqëruesi i rritur të jetë kompetent dhe të ketë marrë përgjegjësinë de facto për atë fëmijë.

Në **NL**, fëmijët konsiderohen të pashoqëruar kur nuk janë të shoqëruar nga prindërit ose nga kujdestarët ligjorë. Fëmijët e shoqëruar nga pjesëtarët e familjes ose nga të afërmit konsiderohen gjithashtu të pashoqëruar dhe prandaj caktohet një kujdestar.

<sup>2</sup> Në **DE**, mund të identifikohen kategoritë e mëposhtme si përgjegjëse për fëmijën, vetëm sipas kërkesave specifike: moshë minimale 18 vjeç, prindër të martuar, nën e pamartuar përveç nëse një gjykatë vendos ndryshe, ose persona të tjerë të caktuar nga gjykata.

<sup>3</sup> EASO nuk i konsideron pjesëtarët e familjes, vëllezërit a motrat ose të afërmit si persona përgjegjës për fëmijën, përveç nëse përkufizohen si të tillë në nivel kombëtar, sipas ligjit ose praktikës të shtetit anëtar në fjalë ose nëse u është dhënë e drejta e kujdestarisë për fëmijën.

<sup>4</sup> Kujdestari/përfaqësuesi do të konsiderohej personi përgjegjës për fëmijën nëse do të kishte dokumente që e vërtetojnë këtë.

<sup>5</sup> Kujdestari/përfaqësuesi do të konsiderohej personi përgjegjës për fëmijën nëse do të kishte dokumente që e vërtetojnë këtë.

## Verifikimi i lidhjeve

Lidhjet prindërore të të rriturit përgjegjës verifikohen në të gjitha rastet në **BE, BG, CY, DE, EE, EL, ES, FR, HU, LV, NL, PL, RO** dhe **SI**, ndërsa në të tjera (**AT, CH, DK, IE, IT, LT, NO, SE** dhe **SK**) vetëm nëse lindin dyshime ose nëse konsiderohet e nevojshme.

Kur janë pyetur në lidhje me metodat që janë përdorur për të verifikuar lidhjet familjare<sup>6</sup>, të anketuarit kanë thënë se mund të bëhet duke kryer analizat e ADN-së (12 shtete të BE+), intervista (8 shtete të BE+) ose nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve zyrtare (17 shtete të BE+).

### Shembuj nga praktika: verifikimi i lidhjeve

Në **EL**, lidhjet prindërore që kanë ekzistuar para hyrjes në vend eksploroohen gjatë intervistës (sipas kuadrit përkatës ligjor të Direktivës për Kualifikimin). Kur ekzistojnë dyshime, dhe nëse nuk ekziston dokumentacioni përkatës për lidhjet familjare, mund të kërkohet bërja e testeve të ADN-së nga Shërbimi i Azilit dhe mund të vihet në dijeni Prokurori Publik.

Në **FI**, bëhet një verifikim shkencor në rastet e ribashkimit familjar.

Në **NO**, të rriturve shoqërues, të cilët nuk janë prindërit biologjikë të fëmijës, u kërkohet të japin dokumentacion ku vërtetohet përgjegjësia prindërore e fëmijës. Nëse përgjegjësia prindërore nuk mund të vërtetohet nëpërmjet dokumentacioneve, fëmija do të trajtohet si i mitur i pashoqëruar.

Në **NL**, i vihet më tepër theks verifikimit të lidhjeve familjare nëse pjesëtarët e familjes janë ndarë në njëfarë pike, si për shembull gjatë procesit të ribashkimit. Në këto raste, kërkohet dokumentacion. Nëse nuk ka dokumentacion të disponueshëm, do të bëhet një intervistë dhe/ose analizë e ADN-së për të përcaktuar lidhjet familjare.

## Fëmijë të pashoqëruar

Tetë shtete të EU+ (**CY, DE, EE, EL, HU, LT, RO** dhe **PL**) përfshijnë përkufizimin **fëmijë i pashoqëruar**<sup>7</sup> siç parashikohet në *acquis* të azilit në BE në sistemin e tyre kombëtar ligjor, ndërsa 14 shtete të EU+ (**BE, BG, CH, DK, ES, FI, FR, IE, IT, LV, NO, SE, SI, SK**) kanë një përkufizim paksa ndryshe. Zakonisht, divergjenca vjen me përkufizimin e BE-së vjen nga fakti se referenca për ata fëmijë që mbeten të pashoqëruar pas hyrjes në territorin e shteteve anëtare hiqet. Në **AT** dhe **NL**, nuk ekziston asnjë përkufizim ligjor për termin fëmijë/i mitur i pashoqëruar, edhe pse **NL** e aplikon sidoqoftë konceptin të fëmijët që nuk janë të shoqëruar nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë.

### Kujdestar dhe/ose përfaqësues

Në procedurat e azilit, figura e kujdestarit dhe/ose përfaqësuesit<sup>8</sup> është e domosdoshme për t'u siguruar që ekzistojnë masa mbrojtëse për fëmijën. *Acquis* i BE-së e përcakton këtë figurë që t'u ndihmojë fëmijëve të ndjekin procedurën duke u dhënë detyra të rëndësishme, si për shembull ushtrimi i kapacitetit ligjor të fëmijës dhe bërja ose paraqitja e aplikimit në emër të fëmijës kur është e nevojshme. Ndër përgjegjësitë përfshihet edhe informimi i fëmijës lidhur me praninë gjatë intervistës personale me qëllim që të bëjë pyetje ose komente etj. Megjithatë, figura dhe roli i kujdestarit dhe/ose përfaqësuesit ndryshon në sistemet kombëtare, të cilat kanë ndikim të ndihma që fëmija merr.

<sup>6</sup> Procesi i përcaktimit të vërtetësisë së një lidhjeje familjare mes fëmijës dhe pjesëtarit të pretenduar të familjes. Udhëzime të mëtejshme për verifikimin e lidhjeve familjare mund të gjenden në EASO, [Udhëzues praktik për gjurmimin e familjes](#), mars 2016.

<sup>7</sup> Përkufizimi ligjor i EASO i nxjerrë nga *acquis* i azilit në BE: Një fëmijë i pashoqëruar është një i mitur që vjen në territorin e shteteve anëtare i pashoqëruar nga një i rritur që është përgjegjës për të qoftë sipas ligjit, qoftë sipas praktikës së shtetit anëtar në fjalë, dhe për sa kohë për të nuk tregohet kujdes i efektshëm nga ky person. Këtu përfshihen të miturit që lihen të pashoqëruar pasi kanë hyrë në territorin e shteteve anëtare.

<sup>8</sup> Sipas pikës 2(n) APD (ndryshim), një përfaqësues do të thotë një person ose organizatë e caktuar nga organet kompetente me qëllim për të ndihmuar dhe përfaqësuar një fëmijë të pashoqëruar në procedurat e mbrojtjes ndërkombëtare me synimin për të siguruar interesat më të mira të fëmijës dhe për të ushtruar kapacitetin ligjor për të miturin aty ku është e nevojshme.

Sipas sistemeve të tyre ligjore, disa shtete të BE+ (**BE, BG, CY, DK, EL, EE, ES, HU, IE, IT, LV, PL, RO** dhe **SE**) njohin **një figurë** që mund të konsiderohet ose si përfaqësues (**BG, CY, DK, EL, ES, RO**) ose si kujdestar (**BE, LV, SE**). Në pesë shtete të BE+ (**EE, HU, IE, IT, PL**), termat kujdestar dhe përfaqësues nuk përdoren të veçuar nga njëri-tjetri.

Në shtete të tjera të BE+ (**AT, CH, DE, FI, FR, LT, NO, SI** dhe **SK**) të **dyja figurat** me role të ndryshme ekzistojnë së bashku në sistemet kombëtare për të mbrojtur fëmijën:

- **Përfaqësues** (**AT** – konsulent ligjor; **CH** – i quajtur gjithashtu zëvendës; **DE** - prindër (mosha minimale 18 vjeç) ose kujdestar ligjor; **FI** - për çështjet ligjore, **FR** - *administrateur ad hoc*; **LT** - me njohuri ligjore; **NO** - një person i pavarur i caktuar gjatë procedurës së azilit; **SI** - i caktuar para se të fillojë procedura e azilit nga qendra e punëve sociale; **SK** - mes personave të ngushtë që kanë lidhje me fëmijën ose institucionale)
- **Kujdestar** (**AT** - i caktuar nga mirëqenia për të rinjtë; **CH** - vullnetarët ose profesionistët e caktuar nga kantonet; **DE** - përgjegjës për kujdesin e fëmijës në rast se nuk ka prindër të disponueshëm; i caktuar nga gjykata pas një kërkesë të shërbimit të mirëqenies për të rinjtë; **FI** - i caktuar nga gjykata për të siguruar BIC pas gjykimit nga punonjësi social nga qendra e pranimit, nuk nevojitet asnjë kualifikim profesional; **FR** - *tuteur*; **LT** - punonjës social; **NL** - punonjësit socialë caktohen nga gjykata si kujdestarë të përkohshëm; **NO** - person i pavarur i caktuar për fëmijët e pashoqëruar, të cilëve u jepet leja për të qëndruar; **SI** - kur u jepet mbrojtje ndërkombëtare; **SK** - për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës dhe mirëqenien e përgjithshme njëloj siç bëjnë prindërit).

**Figura të tjera** Në disa sisteme kombëtare, figura të tjera parashikohen të ndihmojnë fëmijën (**CH** - person i besuar; **DE** - derisa të caktohet një kujdestar, shërbimi i mirëqenies për të rinjtë vepron në vend të prindërve/kujdestarit; **NL** - avokat; **NO** – avokat)


### Autoriteti emërues

Për shumicën e shteteve të BE+, kujdestari/përgjegjësi caktohet nga autoriteti gjyqësor (**AT, DE, EL, FI, FR, IT, LV, NL, PL, SK**) ose nga autoriteti për mirëqenien sociale (**CY, ES, HU, IE, LT, RO** dhe **SI**). Në raste të tjera, autoriteti emërues është shërbimi i kujdestarisë (**BE**), autoriteti rajonal (**CH, DK**) ose autoriteti lokal (**BG, EE, NO, SE**).

Caktimi i një kujdestari/përfaqësuesi është *ex officio* në **nëntë** shtete të BE+ (**DE, FI, LV, HU, NL, PL, RO, SE** dhe **SK**). Ndërkohë, në rastet e mëposhtme, caktimi është nisë e një autoriteti ose organizate tjetër:

- policia ose rojat kufitare në **LV, PL**, dhe **SK**;
- shërbimet e mirëqenies sociale (në rast se kujdestari caktohet nga autoriteti gjyqësor) në **DE, FI** në komplekset e pranimit;
- një OJQ që ka një rol të caktuar për kujdestarinë: në **DK** pas rekomandimit të Kryqit të Kuq Danez, në **NL** nga NIDOS.
- autoriteti i përcaktimit (autoriteti për emigracionin/azilin) në **HU, RO** dhe **SE**.

**Figura 1: Afati kohor për caktimin e një kujdestari**



Në **BE, CH, DE, DK, HU, IE, IT, LV** dhe **SK**, kujdestari/përfaqësuesi caktohet menjëherë pasi fëmija identifikohet si fëmijë i pashoqëruar.

Caktimi i kujdestarit/përfaqësuesit bëhet para se të fillojë procesi për mbrojtje ndërkombëtarë në **FR**<sup>9</sup>, **PL** dhe **SI**, ndërkohë që bëhet në një fazë të mëvonshme kur/pasi paraqitet aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare në **BG**<sup>10</sup>, **CY, EE, EL, LV, LT, NO, RO** dhe **SE**. Në **EL**, nëse fëmija është nën 15 vjeç, duhet të jetë i pranishëm një përfaqësues që fëmija të paraqitë aplikimin.

Në **FI** dhe **NL**, fëmija duhet të mbërrijë në komplekset e pranimit/akomodimit që t'i caktohet një kujdestar/përfaqësues. Në **FI**, menaxheri i qendrës së pranimit merr detyrat e kujdestarit para se të caktohet kujdestari nga gjykata e rrethit.

Në **AT**, koha e caktimit ndryshon nga një rast në tjetrin.

**ES** i kushton vëmendje të menjëhershme çdo të mituri të pashoqëruar/të ndarë, duke e caktuar Entin Publik për Mbrojtjen e të Miturve si përfaqësues ligjor me detyrën e kujdestarisë ligjore për të miturin e pashoqëruar. **ES** nuk ka dhënë informacion shtesë për afatin specifik për caktimin e përfaqësuesit ligjor.

Në **FR**, sapo zbulohet një fëmijë i pashoqëruar ose sapo kërkon mbrojtje ligjore, ai strehohet menjëherë për pesë ditë. Gjatë këtyre ditëve, bëhet një vlerësim për të përcaktuar moshën e të miturit, dhe bëhen përpjekje për të gjetur familjen ose të afërmit dhe për të përcaktuar nevojat specifike të të miturit. Menjëherë sapo përcaktohet se personi është në fakt i mitur, prokurori publik ia beson të miturin autoriteteve për mbrojtjen sociale të fëmijëve (*l'aide sociale à l'enfance*) për 15 ditë dhe ia referon zyrtarisht çështjen gjykatësit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve (*le juge des enfants*). Në të njëjtën kohë, gjykatësi cakton një përfaqësues (*administrateur ad hoc*) për procedurën e azilit.

Gjykatësi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve (*le juge des enfants*) ia beson të miturin shërbimeve për mbrojtjen sociale të fëmijëve derisa të caktohet një kujdestar (*tuteur*). Gjatë periudhës së këtij caktimi, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve marrin masa për mirëqenien e përgjithshme të fëmijës.

Më pas caktohet një kujdestar nga gjykatësi që merret me çështjet familjare, sidomos me kujdestarinë (*juge des tutelles des mineurs*). Kujdestari caktohet deri në moshën 18 vjeç; kujdestari është një përfaqësues ligjor, mund të marrë të gjitha vendimet për të miturin, mund ta përfaqësojë të miturin në procedurat ligjore, ku përfshihet azili, dhe të sigurojë gjithçka që i nevojitet të miturit.

### Kualifikimet

Shumica e shteteve pranuese kanë kërkesa që një person të jetë kujdestar/përfaqësues i një fëmije, edhe pse këto kërkesa ndryshojnë në natyrë. Në 16 shtete të BE+ (**AT, BG, CH**<sup>11</sup>, **CY, DK, EE, FR** (për kujdestarin), **HU, IE, LT, LV, NL, NO, PL, RO** dhe **SK**) kujdestari/përfaqësuesi është një profesionist ose punonjës social/punonjës për mbrojtjen e fëmijëve. Në **AT, DK, IE, LT, NL** dhe **RO**, duhet të ketë një diplomë të certifikuar, ndërsa në **AT, BG, CH, CY, EE, ES, FR** (për kujdestarin), **HU, LV, NO** dhe **PL**, nevojitet ose ofrohet trajnim specifik për të garantuar që kujdestari/përfaqësuesi mund t'i kryejë detyrat e tij.

Në **BE, DK, ES, FI, FR** (për përfaqësuesin), **HU, IT, NO, PL, SE** dhe **SI**, kujdestari/përfaqësuesi mund të jetë një person privat me kualifikime dhe trajnime specifike. Në **HU**, për shembull, kujdestari/përfaqësuesi mund të jetë gjithashtu i rrituri shoqëruar që ka një lidhje të përcaktuar me fëmijën, si edhe një kujdestar profesional. Caktimi i një personi privat si kujdestar/përfaqësues i fëmijës mund të jetë objekt i disa kufizimeve të përkohshme, p.sh. në **FR**, ky person i quajtur "person i tretë i besueshëm" (*un tiers digne de confiance*) caktohet për disa muaj, pas të cilave duhet të kërkojë që të caktohet si kujdestar ligjor ose 'tuteur'.

Disa shtete të EU+ pranojnë persona të tjerë si kujdestarë/përfaqësues të fëmijës. **EL** dhe **DE** parashikojnë që çdo person mund të caktohet si kujdestar/përfaqësues me kusht që të kenë aprovimin e autoritetit

<sup>9</sup> Për përfaqësuesin.

<sup>10</sup> Mund të ndryshojë nga rasti në rast.

<sup>11</sup> Përfshirja e vullnetarëve.

gjyqësor. Në veçanti, në **EL**, të afërmit ose stafi i OJQ-së mund të caktohet si kujdestar/përfaqësues. Të afërmit ose personat e ngushtë mund të caktohen si kujdestarë/përfaqësues edhe në **LV** dhe **SK**. Në **BE**, profesionistët, vullnetarët, personat privatë, si edhe stafi i OJQ-së në sektorin social dhe ligjor mund të caktohen si kujdestarë/përfaqësues të fëmijës. Në **FR**, stafi i OJQ-së mund të caktohet vetëm si përfaqësues i fëmijës ndërsa të afërmit mund të caktohen vetëm si kujdestarë.

#### Shembuj nga praktika: caktimi i një kujdestari/përfaqësuesi

Në **BE**, Shërbimi i Kujdestarisë i kushton vëmendje numrit të kujdestarive që ka tashmë kujdestari. Kujdestari duhet të ketë profilin dhe kompetencat e përshtatshme për t'u marrë me UAM (fëmijë të pashoqëruar), që të jetë i efektshëm dhe të krijojë një marrëdhënie besimi.

Në **FI**, punonjësi social takon fëmijën dhe kandidatin që do të jetë kujdestar, dhe vlerëson nëse kandidati është personi i duhur. Gjithashtu dëgjohet edhe mendimi i fëmijës në këtë aspekt.

Në **SK**, kujdestari/përfaqësuesi është personi i caktuar nga prindërit, nëse nuk bie në konflikt me interesat më të mira të fëmijës. Në mungesë të një personi të tillë, detyrat merren përsipër nga Komuna e Departamentit Social në rastin e fëmijëve të pashoqëruar ose nga Mbrojtja Ligjore e Fëmijëve dhe Kurimi Social në rastin fëmijëve të pashoqëruar.

### Kujdestaria e vendeve të treta

Sipas përgjigjeve të shteteve të BE+, kujdestari/përfaqësuesi i caktuar nga një vend i tretë njihet në **AT, EL, ES, FR**, dhe **HU** nëse caktimi është në përputhje me kuadrin ligjor të tyre. Në **BE, EE, IT** dhe **LT**, personit i kërkohet të japë dokumentacion për të vërtetuar caktimin e tij në vendin e tretë. Në **SE**, kryekujdestari duhet të vendosë nëse duhet të caktohet apo jo një kujdestar.

Caktimi i kujdestarisë/përfaqësimit në një vend të tretë nuk njihet në **BG, DK, FI, IE, NL, SI** dhe **SK**.

Nuk ekziston asnjë praktikë në **DE, CH, LV** dhe **PL** në lidhje me kujdestarinë e vendeve të treta. Në **CY** dhe **NO**, njohja e kujdestarit/përfaqësuesit të caktuar nga një vend i tretë nuk vlen. **RO** nuk ka dhënë informacion lidhur me këtë aspekt.

### Takimi me fëmijën

Në 15 shtete të BE+ (**AT, BE, CH, CY, DE, ES, FR, IE, LT, LV, NL, RO, SE, SI** dhe **SK**) kujdestarit/përfaqësuesit i kërkohet të takohet rregullisht me fëmijën. Në **LT**, komunikimet mes kujdestarit dhe fëmijës bëhen çdo ditë, ndërsa në **DE** dhe **NL**, takimi duhet të bëhet të paktën një herë në muaj.

Në **PL** dhe **NO**, dhe nëse kujdestarit/përfaqësuesit nuk i kërkohet të takohet rregullisht me fëmijën, ai duhet të marrë pjesë në çdo rast në intervistë.

Në pesë shtete të BE+ (**BG, EE, EL, FI** dhe **HU**) nuk kërkohet takimi me fëmijën, përveç nëse është e nevojshme. Për shembull, në **BG**, ky takim bëhet në rastet që përcaktohet me ligj dhe në **EL**, varet nga vendimi i pranuar nga prokurori publik. Në **HU**, takimi duhet të mbahet nëse është në interesat më të mira të fëmijës.

Në **DK** dhe **IT**, takimi nuk kërkohet por në **DK**, është diçka që rekomandohet nga Kryqi i Kuq Danez (dy herë në muaj) dhe në **IT** rekomandohet nga direktivat e Autoritetit të Pavarur për Fëmijët dhe Adoleshentët.

### Mekanizmat e monitorimit

Këto mekanizma përbëhen nga vlerësime të rregullta, si edhe nga adoptimi i masave specifike për të garantuar kryerjen me efikasitet të detyrimeve nga kujdestari/përfaqësuesi i caktuar.

Në 20 shtete të BE+ (**AT, BE, CH, CY, DE, EE, EL, ES, FI, HU, IE, LT, LV, NL, NO, PL, RO, SE, SI** dhe **SK**), ekziston një mekanizëm monitorimi për t'u siguruar që përfaqësuesi/kujdestari t'i kryejë detyrimet sipas parimit të interesave më të mira të fëmijës. Në shumicën e rasteve, organi monitorues do të autoriteti emërues ose autoriteti për mbrojtjen e fëmijës, ndërsa në **DE, EE, EL** dhe **SK** detyrat për monitorimin i takojnë autoritetit gjyqësor.

Në **FR**, nuk ekziston asnjë mekanizëm sistematik, por gjykatësi për të miturit mund të kërkojë raporte dhe mund të rishikojë ankesat në lidhje me kujdestarin, që janë paraqitur nga një i mitur. Përfaqësuesi duhet të bëjë një raport në fund të çdo misioni, dhe çdo katër vjet ekziston mundësia që të përjashtohet nga gjykatësi.

Në **BG**, **IT** dhe **NO** nuk parashikohet asnjë mekanizëm monitorimi.

#### Shembuj nga praktika: mekanizmat e monitorimit për kujdestarët

Në **BE**, kujdestari duhet të hartojë rregullisht raporte para shërbimit për Drejtësinë dhe Kujdestarinë në lidhje me situatën personale të të miturit. Raporti i parë duhet të paraqitet brenda 15 ditësh pas caktimit, raportet e ndërmjetme nevojiten çdo 6 muaj dhe një raport përfundimtar duhet të paraqitet 15 ditë pas mbarimit të kujdestarisë. Mund të merren masa, nga takimet informative deri te paralajmërimet dhe tërheqja e certifikimit në rastin e fundit, kundër kujdestarit/përfaqësuesit nëse nuk i përmbahet detyrimeve që ka kujdestari/përfaqësuesi.

Në **CY**, Shefi i Shërbimit të Azilit bën rregullisht vlerësime, duke përfshirë vlerësim për disponueshmërinë e mjeteve të nevojshme për të përfaqësuar fëmijën e pashoqëruar. Sipas këtyre vlerësimeve, merren masa të përshtatshme për përfaqësimin e efektshëm të fëmijës.

Në **IE**, bëhet një mbikëqyrje klinike çdo 4-6 javë.

Në **DK**, ofrohet trajnim nga Kryqi i Kuq Danez për t'u siguruar që kujdestari/përfaqësuesi t'i kryejë detyrimet sipas parimit të BIC.

Në **LT**, mbikëqyrja e mënyrës se si kujdestari/përfaqësuesi i kryen detyrimet përfshin vizitat me fëmijën dhe vlerësimet për kujdestarinë e fëmijës. Gjatë vizitës dhe gjatë intervistës dëgjohen mendimet e fëmijës dhe të kujdestarit.

Nëse kujdestari/përfaqësuesi nuk i kryen detyrimet në mënyrë të përshtatshme, mund të bëjë që të tërhiqet caktimi i tij (**AT**), të tërhiqen certifikimet e tij (**BE**) ose titulli i tij (**SI**).

#### Kushtet për caktimin e kujdestarit/përfaqësuesit

Pothuajse të gjitha shtetet e BE+ caktojnë një përfaqësues, edhe nëse fëmija i pashoqëruar arrin moshën 18 vjeç para se të merret një vendim në shkallën e parë. Këtu bën përjashtim **RO** (vetëm nëse fëmija arrin moshën 18 vjeç brenda një periudhe 15-ditore pas paraqitjes së aplikimit), dhe **DK** (në rast se ka dyshime derisa DIS<sup>12</sup> të ketë përcaktuar se personi është fëmijë, duke bërë një vlerësim për moshën).

#### Shembuj nga praktika: caktimi i një kujdestari kur fëmija arrin moshën 18 vjeç para se të jetë marrë vendimi përfundimtar

Në **ES**, mbrojtja e fëmijëve të pashoqëruar mund të zgjatet përtej moshës 18 vjeç në raste të caktuara, për ta mbrojtur personin nga rreziqet.

Në **IE**, kujdestari do ta shoqërojë të riun deri në fazën përfundimtare të përcaktimit, pavarësisht nëse fëmija është 17 vjeç, e 11 muaj e 29 ditë kur paraqit aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare.

## Fëmijë të pashoqëruar me të rritur shoqërues (nuk janë përgjegjës për ta)

### Fëmijë të ndarë

Shumica e shteteve të BE+ (**AT**, **BE**, **BG**, **CH**, **CY**, **DE**<sup>13</sup>, **DK**, **EE**, **ES**, **FI**, **FR**, **HU**, **IT**, **LT**, **NL**, **PL**, **RO**, **SE**, **SI**, **SK**) nuk kanë një përkufizim ligjor ose operacional për termin 'fëmijë të ndarë'<sup>14</sup>. Megjithatë, në **EL**, është

<sup>12</sup> Shërbimi Danez për Emigracionin.

<sup>13</sup> Në **DE**, një fëmijë i ndarë është gjithashtu një fëmijë i pashoqëruar. Përkufizimi i të miturit/fëmijës së pashoqëruar zbatohet për fëmijën e ndarë.

<sup>14</sup> "Fëmijët e ndarë" janë fëmijët... të cilët janë ndarë nga të dy prindërit, ose nga kujdestari i tyre ligjor ose kujdestari kryesor i mëparshëm, por jo medoemos nga të afërmit e tjerë.' Komiteti CRC, komenti i përgjithshëm nr. 6 (2005), Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës, 1 shtator 2005, p. 6.



zhvilluar një përkufizim operacional i fëmijëve të ndarë, ndërsa në **IE** dhe **NO**<sup>15</sup> fëmijëve të ndarë u jepet një përkufizim ligjor.

**LV** nuk ka specifikuar asnjë përkufizim për fëmijët e ndarë.

**Fëmijët e ndarë** mund të konsiderohen të shoqëruar ose të pashoqëruar në varësi të rrethanave. Sipas praktikës kombëtare, fëmija i ndarë konsiderohet i shoqëruar nëse:

- shoqërohet nga një pjesëtar i rritur i familjes, nga një përfaqësues statutor (**DK**, dhe **SI**);
- pasi autoriteti përkatës ka konfirmuar lidhjen familjare ose ka zgjedhur një kujdestar të përshtatshëm **IE** dhe **LV**).

Në 19 shtete të BE+ (**BE, BG, CH**<sup>16</sup>, **CY, DE, EE, EL, ES, IE**<sup>17</sup>, **FI, FR**<sup>18</sup>, **HU, LT, LV**<sup>19</sup>, **NL, PL**<sup>20</sup>, **RO, SE** dhe **SK**), fëmijët e ndarë konsiderohen fëmijë të pashoqëruar, ndërsa në **IT**, fëmijët e ndarë mund të konsiderohen si të shoqëruar ose të pashoqëruar në varësi të rrethanave të secilit rast.

Në **AT**<sup>21</sup>, ky dallim nuk vlen.

#### Shembull nga praktika:

Në **LV**, menjëherë sapo një i mitur i pashoqëruar paraqet një aplikim për azil, Gjykata për Jetimë do të vendosë menjëherë për caktimin e një kujdestari për të miturin e pashoqëruar. Gjykata për Jetimët dhe autoritetet përcaktuese do të marrin masa për të parë pjesëtarët e familjes së të miturit dhe për të siguruar mundësitë për t'ia kthyer këtë person familjes së tij.

Nëse i afërmi më i afërt është i përshtatshëm për të marrë kujdestarinë e fëmijës, atëherë Gjykata për Jetimë do të konfirmojë rolin e tij si kujdestar. Nëse nuk gjendet asnjë person i afërm që është në gjendje të kujdeset për të miturin (ata që janë në gjendje, nuk kanë mundësi të marrin kujdestarinë ose të shkarkohen nga përgjegjësia e kujdestarisë për arsye ligjore), ose nëse një i mitur nuk ka asnjë të afërm, atëherë gjykata për jetimët do të caktojë dikë tjetër si kujdestar. Gjykata vepron vetë me vendimin e saj, menjëherë sapo informohet se ka jetimë të tillë.

Në **ES**, fëmijët e ndarë që konsiderohen se janë në situatë rreziku, u nënshtrohen vlerësimeve dhe mbikëqyrjeve të caktuara për t'u siguruar ndihmë dhe për të plotësuar nevojat e tyre për pranim.

Në **NL**, fëmijët konsiderohen të pashoqëruar kur nuk janë të shoqëruar nga prindërit ose kujdestarët ligjorë. Fëmijët e shoqëruar nga pjesëtarët e familjes ose nga të afërmit konsiderohen gjithashtu të pashoqëruar dhe prandaj caktohet një kujdestar.

## Fëmijë të martuar

Shumica e shteteve të BE+ (**AT, BE, CH, CY, DE, EL, FI, IE**<sup>22</sup>, **LT, NL, NO, PL, SE** dhe **SK**) i kategorizojnë fëmijët e martuar si fëmijë të pashoqëruar. Megjithatë, në shtatë shtete të EU+ (**DK, EE, ES, FR, HU, IT** dhe **SI**), fëmijët e martuar mund të konsiderohen të shoqëruar në varësi të moshës, ligjit vendës ose vlerësimit individual që është bërë. Në dy shtete të EU+ (**BG**<sup>23</sup> dhe **LV**), fëmijët e martuar konsiderohen të rritur.

Në **CH, CY, DE, EL** dhe **DK**, një kujdestar/përfaqësues caktohet për ta ndihmuar fëmijën, si edhe në **BE**, ku në rastin e martesave zakonore, caktohet një kujdestar i eksperimentuar.

<sup>15</sup> Në veçanti, **NO** i nje fëmijët që mund të shoqërohen nga pjesëtarë të tjerë të familjes/të rritur të tjerë shoqëruar, si një kategori e caktuar me procedura dhe masa të caktuara që zbatohen për fëmijët e pashoqëruar.

<sup>16</sup> Ndërkohë që kujdestaria që mban i rrituri shoqëruar ose i afërmi nuk është e qartë.

<sup>17</sup> Ndërkohë që lidhja familjare nuk është konfirmuar nga TUSLA, Agjencia Shtetërore për Fëmijët dhe Familjet.

<sup>18</sup> Nëse nuk ka të rritur që konsiderohen përgjegjës për fëmijën. Në këtë rast, do të caktohet një përfaqësues nga gjykatësi.

<sup>19</sup> Në **LV**, derisa gjykata për jetimët të zgjedhë një kujdestar të përshtatshëm.

<sup>20</sup> Në **PL**, fëmijët e ndarë mund të akomodohen me të afërmit, nëse kanë dokumente që janë të afërm të familjes.

<sup>21</sup> Kuadri ligjor nuk jep përkufizim për një fëmijë të shoqëruar apo të pashoqëruar. Ligji operon në këtë kontekst me termat "të mitur", interesat e të cilëve nuk mund të ushtrohen nga përfaqësuesi i tyre ligjor".

<sup>22</sup> Nëse të dy fëmijët janë mbi 18 vjeç.

<sup>23</sup> Nëse janë mbi 16 vjeç.

**RO** nuk ka përcaktuar se si konsiderohen fëmijët e martuar sipas politikave dhe proaktive vendëse.

### **Njohja e martesës së fëmijëve**

Mosha e bashkëshortëve ose e ligjshmërisë/pajtueshmërisë me ligjin vendës<sup>24</sup> janë faktorë që merren parasysh nga shumica e shteteve të BE+ për njohjen e martesës. Për këtë arsye, kjo do të ketë ndikim të vendi specifik, përveçse në **gjashtë shtete të BE+ (CH<sup>25</sup>, DE, DK, LT, NL dhe SK)** të cilat kanë raportuar se martesë nuk njihet në rastet ku një prej bashkëshortëve është fëmijë.

#### **Shembuj nga praktika:**

**DE** një ligj i ri hyri në fuqi në vitin 2017 lidhur me martesën e fëmijëve. DE përcakton moshën e aprovimit prej 18 vjeç për çdo person (shtetas ose të huaj), që jeton në territorin kombëtar. Prandaj, martesë konsiderohet e pavlefshme në rastet ku një prej bashkëshortëve ka qenë më pak se 16 vjeç në kohën e lidhjes së martesës. Në rastet kur bashkëshortët janë nën 18 vjeç, vendimi duhet të merret nga gjykata.

Sipas hartimit FRA, kërkesat për moshën minimale në lidhje me të drejtat e fëmijëve në BE vetëm në **DE, DK, NL dhe SE** (si edhe në **PL**, por vetëm për sa u përket burrave, vajzat mund të martohen 16 vjeç), nuk ekziston mundësia për t'u martuar nën 18 vjeç, siç rekomandohet nga Komiteti CRC. Në **ES**, fëmijët e ndarë që konsiderohen se janë në situatë rreziku, u nënshtrohen vlerësimeve dhe mbikëqyrjeve të caktuara për t'u siguruar ndihmë dhe për të plotësuar nevojat e tyre për pranim.

Në **NL**, fëmijët konsiderohen të pashoqëruar kur nuk janë të shoqëruar nga prindërit ose kujdestarët ligjorë. Fëmijët e shoqëruar nga pjesëtarët e familjes ose nga të afërmit konsiderohen gjithashtu të pashoqëruar dhe prandaj caktohet një kujdestar.

### **Vlerësimi i situatës së fëmijëve të martuar**

Shumica e shteteve (**BE, BG, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IE<sup>26</sup>, IT, NL** (për pranimin), **NO, PL<sup>27</sup>, SE<sup>28</sup>** dhe **SK**) bëjnë një vlerësim të situatës së rrezikut të mundshëm për fëmijën e martuar. Në mënyrë më të veçantë, BIC vlerësohet në mënyrë specifike në katër shtete të BE+ (**DK, EL, FR dhe NL**). Rrezikueshmëria e fëmijës (**BE**) dhe rreziku që të bëhet viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (THB), kontrabandës, shfrytëzimit ose abuzimit seksual janë faktorë që shtetet e BE+ i kushtojnë vëmendje kur bëjnë vlerësimin.

Në disa shtete të EU+ (**DK, FI, IT** (intervistat psikosociale), **NO, SE**) bëhet një intervistë për të vlerësuar riskun, dhe në **DK dhe HU**, analizohet marrëdhënia mes bashkëshortëve. Në **SE**, bëhet intervista pa bashkëshortin nëse fëmija është nën 15 vjeç.

**RO** nuk ka specifikuar se si bëhet vlerësimi i situatës së fëmijëve të martuar.

#### **Shembuj nga praktika: vlerësimi i rasteve të martesave të fëmijëve**

Në **BE**, vëmendje e veçantë i kushtohet martesave zakonore, pasi ky mund të jetë një tregues i riskut ekstrem. Caktohet një kujdestar që të merret me situatën dhe që ta ndihmojë fëmijën, ndërkohë që merren masa të tjera për të garantuar sigurinë e fëmijës, si për shembull akomodime të përshtatshme veçmas nga bashkëshorti.

Në **CY**, fëmijët e martuar konsiderohen fillimisht fëmijë të pashoqëruar dhe bëhet një vlerësim i mëtejshëm i secilit rast nga Shërbimet e Mirëqenies Sociale.

<sup>24</sup> Informacion i dobishëm lidhur me moshën minimale për t'u martuar dhe kërkesat sipas ligjeve kombëtare të BE-së gjenden në FRA Hartimi i kërkesave për moshën minimale lidhur me të drejtat e fëmijës në BE në <http://fra.europa.eu/en/publication/2017/mapping-minimum-age-requirements/marriage-age>

<sup>25</sup> Zyrat e gjendjes civile kantonale janë përgjegjëse për procedurën e njohjes së martesave. Zakonisht, kjo lloj martesë nuk njihet.

<sup>26</sup> IPO i referohet mendimit profesional të Agjencisë për Fëmijët dhe Familjet - TUSLA për vlerësimin e riskut në të gjitha rastet ku përfshihen të mitur. Të gjitha këto raste referohen.

<sup>27</sup> Vëmendje e veçantë i kushtohet vlerësimit të rrezikut për abuzime seksuale.

<sup>28</sup> SMA bën një raport të shërbimit sociale dhe të policia nëse fëmija është nën 15 vjeç. Në këto raste, është e rëndësishme që fëmija të intervistohet pa bashkëshortin shoqëruar.

Në **DK**, bashkëshortët ndodhen fillimisht në komplekse pranimit të veçuara (fëmija në një kompleks të pranimit të fëmijëve) dhe bëhet një vlerësim i kujdesshëm nga Shërbimi Danez për Emigracionin. Vlerësimi përfshin intervista të veçanta qoftë me të miturin, qoftë me bashkëshortin, si edhe vlerësim të faktorëve të tjerë, si për shembull nëse çifti ka pasur një bashkëjetesë të gjatë, nëse kanë pasur fëmijë dhe tregues të tjerë të martesës me detyrim. Sido që të jetë, nëse fëmija konsiderohet i shoqëruar nga bashkëshorti, caktohet gjithnjë një përfaqësues personal.

Në **ES**, masat që merren ndryshojnë në varësi të moshës së bashkëshortëve:

- Nëse të dy bashkëshortët janë nën 16 vjeç, ata vendosen së bashku për qëllimet e pranimit, por trajtohen si fëmijë të pashoqëruar.
- Nëse një prej bashkëshortëve është nën 16 vjeç (zakonisht një vajzë), ajo konsiderohet si fëmijë i pashoqëruar në situata rreziku dhe merren në konsideratë masa specifike në pranim. Merren masa për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës, p.sh. vizita të mbikëqyrura të bashkëshortit, dhe hyrja e dalja nga banesa do të monitorohet me kujdes.
- Nëse një prej bashkëshortëve është ndërmjet 16 dhe 18 vjeç, vlerësimi i situatës merret në shqyrtim individualisht. Në varësi të vlerësimit, bashkëshorti mund të konsiderohet i rritur përgjegjës dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme të merren masa specifike.

## I rrituri shoqëruar dhe bashkëshorti i fëmijës

### ➤ Shënim për terminologjinë

“I rritur shoqëruar” mund të përkufizohet si një i rritur që duket se e shoqëron fëmijën para autoriteteve, por i cili nuk është i rritur përgjegjës për fëmijën

Në shumicën e sistemeve ligjore kombëtare të shteteve të BE+ (**AT, BE, CY, DE, EE, ES, FI, FR, HU, IT, LT, LV, NL, NO, PL, RO, SE, SI** dhe **SK**) nuk ekziston asnjë përkufizim operacional. Pesë shtetet e tjera të BE+ (**BG, CH, DK, EL** dhe **IE**) kanë inkorporuar figurën e “të rriturit shoqëruar” siç përkufizohet më sipër brenda sistemeve të tyre ligjore kombëtare. Katër prej këtyre shteteve të BE+ (**BG, CH, EL** dhe **IE**) e njohin të rriturin shoqëruar si përfaqësues/kujdestar të fëmijës.

Përgjigjet kanë treguar se në shtetet ku njihet kjo figurë, nuk është e nevojshme që i rrituri të ketë lidhje familjare me fëmijën në shtatë prej shteteve të BE+ (**BE, EL, FR, IE, NL, SE** dhe **SK**). Në tetë shtete të tjera të BE+ (**BG, DK, EE, FI, NO, PL, RO** dhe **SI**), ky është një kusht që personi të konsiderohet i rritur shoqëruar i fëmijës. Më në veçanti, në **DK**, parashikohet një përjashtim në rast se fëmija i ka humbur të dy prindërit dhe personi ka qenë kujdestari kryesor që në lindje.

Në **CH** dhe **ES**, zakonisht nuk janë të nevojshme lidhjet familjare që personi të konsiderohet i rritur shoqëruar, ndërsa në disa shtete të tjera (**AT, CY, DE, HU, IT, LT** dhe **LV**) lidhjet familjare nuk aplikohen.

### Shembuj nga praktika: i rritur shoqëruar

Në **SI**, në rastet ku një i mitur shoqërohet nga një person i cili nuk është i afërm, ka shumë të ngjarë që i mituri të konsiderohet i pashoqëruar dhe t’i caktohet një përfaqësues ligjor. Kjo është gjithashtu e rëndësishme, duke pasur parasysh mundësinë e trafikimit.

Në **NL**, fëmijët konsiderohen të pashoqëruar kur nuk janë të shoqëruar nga prindërit ose kujdestarët ligjorë. Fëmijët e shoqëruar nga pjesëtarët e familjes ose nga të afërmit konsiderohen gjithashtu të pashoqëruar dhe prandaj caktohet një kujdestar.

I rrituri mund të luajë rol në procedurën e azilit në 14 shtete të BE (**BG, CH, DE, DK, EE, EL, ES, FR, IE, NO, LV, PL, SE** dhe **SK**), në veçanti:

- si përfaqësues ligjor në shtete të BE+ (**BG, CH, EL, FR** - vetëm nëse gjykatësi i jep autoritetin prindëror, **IE, LV** - nëse caktohet nga gjykata për jetimët **SK** - nëse caktohet nga gjykata);
- me një rol pjesëmarrës në një fazë të procesit të azilit në tre shtete të BE+ (**EL, ES** dhe **IE**);
- duke dhënë informacion, në katër shtete të BE+ (**DE, DK, NO** dhe **SE**);
- duke siguruar BIC në **EE** dhe **EL**;

- duke qenë i pranishëm/duke marrë pjesë në intervistën e fëmijës (**DK** dhe **PL**<sup>29</sup>).

Në disa shtete (**BE, FI, HU, NL** dhe **SI**) të rriturit shoqërues nuk luajnë asnjë rol në procedurën e azilit dhe është diçka që nuk zbatohet në **AT, CY, IT, LT** dhe **RO**.

I rrituri shoqërues dhe bashkëshorti i rritur nuk konsiderohen kujdestarë/përfaqësues të fëmijës në **FI, FR**<sup>30</sup>, **LT, NO, SE** dhe **SI**. Në **BE**, gjykata vendos nëse një i rritur shoqërues mund të emërohet si kujdestar civil i fëmijës pasi kanë mbaruar procedurat për të marrë lejen për të qëndruar në Belgjikë. Megjithatë, gjatë procedurës së azilit, një i rritur shoqërues nuk mund të emërohet si kujdestar i fëmijës.

Në disa shtete të BE+, mundësia e emërimit të bashkëshortit të rritur ose shoqëruesit të rritur si kujdestar/përfaqësues të fëmijës parashikohet në rrethana të ndryshme:

- Nëse caktohet nga një gjykatë dhe kur është në BIC në **AT**. Në **DE**, çdo gjykatë vendos për kërkesat për caktimin. Në **EL**, mund të caktohet nga një prokuror publik.
- In **FR**, mund të caktohet vetëm si kujdestar, jo si përfaqësues. Në **IE**, caktohet si kujdestar/përfaqësues, përveç nëse shteti ka dyshime për sa i përket sigurisë së fëmijës. Për sa i përket të rriturit shoqërues, ai do të caktohet nëse fëmija është nën kujdesin e tij dhe duke marrë parasysh dëshirën e fëmijës dhe BIC.
- Në **NL**, nëse kërkohet nga Nidos, ndërkohë që bëhet një vlerësim në **SK** për të verifikuar nëse i rrituri shoqërues ose bashkëshorti i rritur është i pjekur moralisht dhe fizikisht për të kryer detyrimet e një kujdestari.
- Në **BG** dhe **EE**, bashkëshorti i rritur mund të caktohet nëse martesë është sipas ligjit.
- **ES, HU, CY** dhe **LV** nuk kanë treguar asnjë kërkesë specifike që zbatohet.

Në **CH, DK, IT** dhe **PL**, i rrituri shoqërues mund të caktohet si kujdestar/përfaqësues, por bashkëshorti i rritur nuk mund të caktohet si kujdestar/përfaqësues i fëmijës. Në **CH**, i rrituri shoqërues caktohet si kujdestar/përfaqësues nëse i ka ushtruar këto funksione në CoO, ndërsa në **PL** ky opsion merret parasysh vetëm kur ekzistojnë vështirësi për të gjetur një kujdestar tjetër për fëmijën.

Në **RO**, kjo praktikë nuk zbatohet.

Për të garantuar mbrojtjen e fëmijës, caktohet një përfaqësues në **DK** nëse i mituri konsiderohet i riskuar ose i shoqëruar nga bashkëshorti. Në **FR** caktohet një përfaqësues nëse ekziston rreziku i konfliktit të interesit **LV** nëse fëmija nuk ka asnjë të afërm dhe në **SI** nëse fëmija është me të rriturin shoqërues ose nëse është nën 15 vjeç dhe është i martuar.

<sup>29</sup> Nëse fëmija ka dëshirë.

<sup>30</sup> Jo si përfaqësues, që do të thotë se i rrituri shoqërues mund të caktohet si kujdestar.

## Seksioni 2. Interesat më të mira të fëmijës në procedurat e azilit

Detyrimi për të siguruar interesat më të mira të fëmijës si konsiderim kryesor në të gjitha vendimet që prekin fëmijën vjen nga pika 3 e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC)<sup>31</sup>, pika 24 e Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore, dhe është përsëritur në *acquis* të azilit në BE. Megjithatë, implementimi i parimeve përbën sfida të shumta për autoritetet dhe për palët e tjera. Për të dalluar këto sfida dhe boshllëqet e mundshme, si edhe praktikatat e mira që mund të kopjohen, EASO e ka adresuar këtë temë te pyetësori, së bashku me zbulimet e rëndësishme të mëposhtme:

### Proces për vlerësimin e BIC në procedurat e azilit

Në këtë aspekt, 11 shtete (**BE, BG, CH, CY, DK, EE<sup>32</sup>, IE, ES, FR, LV dhe SE**) ndjekin një proces formal për të vlerësuar BIC në lidhje me procedurën e azilit.

BIC është një konsiderim kryesor në procedurën e azilit në **AT, DE, EL, PL, FI, IT, NO dhe SK**, megjithëse këto vende kanë konfirmuar se nuk ka asnjë proces formal për vlerësimin e BIC.

Në mënyrë të ngjashme, në **FI, HU<sup>33</sup>, LT, NL, PL, RO dhe SI** nuk ekziston një proces formal për të vlerësuar BIC, por ekzistojnë disa masa sigurie. Në **NL**, nëse lind nevoja për të vlerësuar BIC, përfshihet Nidos dhe Këshilli për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në **PL**, BIC vlerësohet në kuadrin e vlerësimit të nevojave për mbrojtje ndërkombëtare. Në **SI**, duhet të konsiderohet një shqetësim kryesor në të gjitha fazat e procedurës së azilit dhe nga të gjitha autoritetet dhe personeli i përfshirë.

### Kur bëhet vlerësim i BIC

Sipas praktikës, vlerësimi i BIC mund të bëhet në momente të ndryshme, në disa raste para nisjes së procedurës së azilit (**IE dhe SK<sup>34</sup>**), ose në një fazë të caktuar të procedurës, për shembull fëmija ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare si në **BG dhe EL** (kur prokurori është informuar siç duhet<sup>35</sup>). Në **PL**, vlerësimi bëhet kur merret një vendim për mbrojtje ndërkombëtare.

Megjithatë, shumica e shteteve të pyetura kanë thënë se vlerësimi mund të bëhet në të gjitha fazat e procedurës së azilit. Kështu ndodh në 16 shtete të BE+ (**AT, BE, CH, CY, DE, DK, EE, ES, FI, FR<sup>36</sup>, IT, LV, NO, SE, SI dhe SK**). Më në veçanti, në **ES dhe FI**, vlerësimi i BIC bëhet gjithashtu në qendrat e pranimit.

Në disa shtete (**HU, LT, NL dhe RO**) ku nuk ekziston një proces për vlerësimin e BIC, kjo pyetje nuk aplikohet.

<sup>31</sup> Pika 3.1: “Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, pavarësisht nëse ndërmerren nga institucionet publike apo private të mirëqenies sociale, gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative, interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë meraku kryesor; 3.2 Palët shtetërore marrim përsipër të sigurohen që fëmija të marrë këtë mbrojtje dhe kujdes, siç shihet i nevojshëm për mirëqenien e tij, duke marrë parasysh të drejtat dhe detyrimet e prindërve, kujdestarëve ligjorë ose personave të tjerë që kanë përgjegjësi ligjore ndaj tij, dhe për këtë, do të ndërmarrë të gjitha masat e përshtatshme legjislative dhe administrative; 3.3 Palët shtetërore do të sigurohen që institucionet dhe shërbimet përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve do të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara nga autoritetet kompetente, në veçanti në fusha të sigurisë, shëndetit, në numrin dhe përshtatshmërinë e stafit, si edhe në mbikëqyrjen kompetente.” Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa për të drejtat e fëmijëve, 20 nëntor 1989, Kombet e Bashkuara, Seri Traktatesh, vëll. 1577, f. 2.

<sup>32</sup> Garantuar nga kujdestari.


<sup>33</sup> Rregullat për të siguruar aplikimin e BIC do të zgjaten deri në ndryshimin e radhës të Ligjit Hungarez për Azilin.

<sup>34</sup> Fillon nga momenti që gjendet fëmija.

<sup>35</sup> Përndryshe, bëhet gjatë intervistës.

<sup>36</sup> Në **FR**, vlerësimi BIC fillon menjëherë sapo gjendet një i mitur i pashoqëruar; nuk varet nga ekzistenca/fazat e procedurës së azilit. BIC vlerësohet në të njëjtën kohë me vlerësimin e moshës dhe më vonë nga autoriteti përcaktues.

Figura 2: Afati i BIA (\*duke përfshirë në fazën e pranimit)

**Shembuj nga praktika: vlerësimi i interesave më të mira**

Në **CY**, pas paraqitjes së aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare, aplikuesit i jepet një formular i veçantë për identifikimin e personave të cenueshëm. Vlerësimi i BIC bëhet nga Shërbimet e Mirëqenies Sociale vazhdimisht derisa fëmija të bëhet 18 vjeç.

Në **LV**, BIC vlerësohet gjatë të gjithë procedurës së azilit me anë të vërejtjeve dhe komunikimit me gojë, ku fëmija kontaktohet në raste të ndryshme.


Në **NO**, vlerësimi i BIC nga Drejtoria Norvegjeze e Emigracionit kërkon që fëmijës t'i jepet mundësia të shprehë mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të.

**Aktorët që përfshihen në vlerësimin e BIC**

Në 15 prej shteteve të BE+ (**AT, BG, CY, DE, DK, EE, ES, FI, FR, IE, IT, LV, NL, SE dhe SK**), autoritetet e ndryshme ndajnë mes tyre përgjegjësinë për vlerësimin e BIC (ndër të tjerë, autoritetet e azilit, autoritetet e pranimit, autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve, agjencitë e mirëqenies sociale, gjyqësori, kujdestari ose përfaqësuesi i fëmijës). Në **EL**, prokurori publik bën vlerësimin e BIC, ndërsa autoritetet e tjera janë gjithashtu përgjegjëse në varësi të fazës së procedurës. Në **SK**, të gjitha autoriteteve që punojnë me të miturit u kërkohet që të vlerësojnë BIC.

Në **HU, LT, RO dhe SI** kjo nuk zbatohet. Sipas zbulimeve, autoritetet e mëposhtme kanë përgjegjësinë kryesore në vlerësimin e BIC në shtetet përkatëse të BE+:

**Figura 3: Aktorët e përfshirë në procesin e vlerësimit të interesave më të mira të fëmijës**



Aktorë të tjerë mund të marrin gjithashtu pjesë në procesin e vlerësimit të BIC lidhur me çështje të caktuara të BIC. Kjo ndodh për:

- Kujdestarin/përfaqësuesin: **AT, BE, DE, DK, EE, IE, NO, SE, SK**<sup>37</sup>;
- OJQ-të në **BG, CY** dhe **LV**;
- Personeli shëndetësor ose personeli i shkollës: **DK, FI, IT** dhe **NO**.

### Vlerësimi i BIC në rastin e të rriturit shoqërues si kujdestar/përfaqësues

Në rast të një emërimi të mundshëm të një të rrituri shoqërues si kujdestar të fëmijës, bëhet një vlerësim i interesave më të mira para emërimit në 11 shtete të BE+ (**AT, DE, DK, EE, EL, ES, FR, IT, LV, PL** dhe **SK**). Më në veçanti, vlerësimi dhe emërimi bëhet në gjykatë në **AT, FR, IT, LV** dhe **SK**<sup>38</sup>. Në **EL**, prokurori publik është ai që cakton kujdestarin dhe/ose përfaqësuesin e të miturit, duke marrë parasysh vlerësimin e bërë nga autoritetet e tjera.

Në **BE** dhe **NO**, nuk bëhet vlerësim i interesave më të mira para emërimit të një të rrituri shoqërues.

#### Shembuj nga praktika: vlerësimi i interesave më të mira


Në **IE**, konsiderohet në interesat më të mira të çdo të mituri të pashoqëruar në shtet që të caktohet menjëherë një punonjës social (i cili vepron në loco parentis si kujdestar i fëmijës).

**BG, CY, FI, IE, LT, RO, SE** dhe **SI** kanë thënë se kjo praktikë nuk zbatohet në sistemet e tyre. Përgjigjet e **CH, HU** dhe **NL** nuk kanë dhënë asnjë specifikim të mëtejshëm në lidhje me këtë pyetje.

### Mjetet dhe mekanizmat për cilësinë

Dymbëdhjetë shtete të BE+ përdorin mjete për të ndihmuar funksionarin përgjegjës të vlerësojë interesat më të mira të fëmijës, ndërsa në pesë shtete (**BE, IT, LT, LV, PL**) nuk përdoret asnjë mjet. Mjetet që janë përdorur nga shtetet e BE+ ishin:

**Figura 4: T'i ndihmojmë funksionarit përgjegjës të vlerësojë cilat janë interesat më të mira të fëmijës**



<sup>37</sup> Fëmijës i jepet gjithashtu mundësia të japë informacion në **SK**.

<sup>38</sup> Gjykata për jetimët do të marrë vendim sipas mendimit të Zyrës për Çështjet e Shtetësisë dhe Emigracionit.



7 shtetet e BE+ (**AT, CY, DE, DK, EL, FR** dhe **NO**), në të cilat përdoren udhëzime ose direktiva, kanë specifikuar se direktivat e UNHCR, si edhe direktivat dhe mjetet praktike të EASO<sup>39</sup> përdoren për të ndihmuar funksionarët përgjegjës të vlerësojnë BIC.

Në **AT, CH, CY, DE, EL** dhe **FR**, funksionarëve përgjegjës për vlerësimi e BIC u ofrohet trajnim. Në **SE**, ekziston një listë për vlerësimin e BIC ku përfshihen të gjitha fazat e procedurës së azilit.

Në **FI, FR, IE** dhe **SK**, kërkohet opinioni i ekspertëve të tjerë kur bëhet vlerësimi nga funksionari përgjegjës. Më në veçanti, në **IE**, gjatë procesit të pranimit klinik të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, vlerësohet BIC dhe bëhen rekomandimet TUSLA para autoriteteve të azilit kur është e nevojshme.

#### Shembull nga praktika:

**SMA** (Agjencia Suedeze për Emigracionin) po zhvillon politikën e saj për fëmijët dhe dokumente të ndryshme drejtuese për të forcuar të drejtat e fëmijëve në përputhje me CRC. Gjithashtu do të zhvillohen disa trajtime në BIC dhe do të implementohen në agjenci në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018.

Që prej vitit 2013, **OFPPA**, autoriteti përcaktues francez, ka përcaktuar një grup me ekspertë të specializuar për nevojat procedurale të veçanta të fëmijëve, i ngarkuar me detyrën për të zhvilluar direktiva të brendshme për vlerësimin e aplikimeve të fëmijëve të pashoqëruar, trajnimin e funksionarëve të çështjeve dhe dhënien e ndihmës me vlerësimin e çështjeve.

Disa shtete (**BG, EE, ES, HU, NL, RO** dhe **SI**) nuk ka dhënë informacion specifik për këtë aspekt.

<sup>39</sup> Shiko Mjeti EASO për identifikimin e personave me nevoja të veçanta, i cili mund të gjendet online në <https://ipsn.easo.europa.eu/>; EASO, *Udhëzime praktike për gjurmimin e familjes*, mars 2016; UNHCR, *Raportimi i mirë dhe i sigurt*, 2014; EASO, Modul trajnimi për intervistimin e personave të rrezikuar; UNHCR, *Direktiva për përcaktimin e interesave më të mira të fëmijës*, maj 2008; UNHCR, *Direktiva për mbrojtjen ndërkombëtare nr. 8: Kërkesat e azilit për fëmijë, pika 1(A)2 dhe 1(F) e Konventës 1951/ose Protokollin 1967 për statusin e refugjatëve*, (2009).

## Seksioni 3. Procedurat e azilit për fëmijët

Kjo pjesë përmbledh masat mbrojtëse dhe kushtet e veçanta që u jepen fëmijëve në procedurat e azilit; në veçanti i kushtohet vëmendje ndryshimeve mes fëmijëve të shoqëruar dhe atyre të pashoqëruar, dhe se si prania e aktorëve përkatës (kujdestar/përfaqësues, të rritur shoqëruar, etj.) mund të ndikojë te aplikimi i këtyre masave mbrojtëse dhe kushteve.

### Mekanizmi për identifikimin e nevojave procedurale të fëmijëve

Në 10 shtete të BE+ (**CY, DK, EL, ES, LT, NL, NO, RO, SE** dhe **SI**) ekziston një mekanizëm për identifikimin e nevojave procedurale të veçanta të fëmijëve, ndërsa (**AT, LV, PL** dhe **SK**) nuk ekziston një mekanizëm i tillë.

Në veçanti, në **NL**, ekziston një procedurë e veçantë për viktimat e THB dhe një analizë risku multidisiplinore e riskut. **SE** e proceson secilin rast duke ndjekur një procedurë të veçantë në lidhje me rrethanat që janë specifike për fëmijët dhe që mund të jenë bazë për azil.

Në **BG, DE, ES, FI, HU, IE** dhe **IT**, nuk ekziston asnjë mekanizëm formal, por ka disa garanci për identifikimin e nevojave procedurale të veçanta të fëmijëve. Për shembull, në **BG**, gjatë procedurës, ka në dispozicion ekspertë socialë, psikologë, konsulentë ligjorë dhe profesionistë të tjerë për të dhënë ndihmën e nevojshme. Në **FI**, kujdestari vlerëson nevojat procedurale të fëmijës dhe i komunikon njësisë së azilit çdo nevojë të veçantë.

Në **CH**, ndiqet CRC për këtë aspekt.

**EL** dhe **EE** ndjekin mjetet e EASO dhe direktivat e UNHCR.

Dy shtete (**BE** dhe **FR**) nuk kanë dhënë informacion.

#### Shembuj nga praktika: mekanizma për identifikimin e nevojave procedurale të veçanta të fëmijëve:

Në **SI**, të gjithë fëmijët konsiderohen persona të rrezikuar me nevoja të veçanta, dhe si të tillë, u jepet kujdes dhe trajtim i veçantë. Natyra e nevojave të tyre të veçanta vlerësohet individualisht dhe në çfarëdo pike gjatë procedurës së azilit.

### Masat mbrojtëse procedurale për fëmijët

#### Prioritizimi i ekzaminimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare

Kur aplikuesi është fëmijë, pavarësisht nëse është i shoqëruar ose i pashoqëruar, ekzaminimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare i jepet prioritet në **BE** (nëse është e mundur), **EE, EL, FI, IE, IT, NO, PL, RO, SE, SI** dhe **SK** (nëse është sipas BIC).

Kur fëmija është i pashoqëruar, në **CY** rastit i jepet prioritet (përveç rasteve të ribashkimit të familjes), **DE, DK** (nëse fëmija është i shoqëruar nga të rritur të tjerë përveç prindërve, ose është i pashoqëruar), **ES, FR** (aty ku është e nevojshme, në varësi të bazave të fëmijës ose prindërve), **HU**, dhe **LT**.

Në **NL**, intervistave mund t'u vihet prioritet nëse është e nevojshme ndërsa ekzaminimit të aplikimit për azil nuk i vihet prioritet në **AT** dhe **LV**.

Në **IT**, nëse aplikuesi është fëmijë, kjo gjë njoftohet menjëherë kur regjistrohet aplikimi për azil nga Zyrat Qendrore të Policisë Provinciale në Komisionin Territorial për të proceduar me prioritizimin dhe caktimin e një intervistuesi të specializuar.

**CH** nuk është nën detyrimin e APD dhe nuk e zbaton atë.

## Procedurat kufitare dhe ato të përshpejtuara

Në disa shtete (**AT, EE, EL, ES<sup>40</sup>, HU<sup>41</sup>, IT, LT<sup>42</sup>, NO, RO, SE** dhe **SK**), në rastin se aplikuesi është një fëmijë i shoqëruar, aplikohen procedurat kufitare dhe ato të përshpejtuara.

Në rastet ku fëmija është i pashoqëruar, në **FI** normalisht këto procedura nuk aplikohen.

Në tetë shtete të BE+ (**CY, DE<sup>43</sup>, DK, FR<sup>44</sup>, HU<sup>45</sup>, LV, PL** dhe **SI**), procedurat kufitare dhe/ose ato të përshpejtuara aplikohen gjithashtu për fëmijët e pashoqëruar, duke përfshirë fëmijët e ndarë. Në disa prej këtyre shteteve, (**HU, LV** dhe **SI**), procedurat aplikohen kur plotësohen kushtet e përcaktuara. Më në veçanti, në **LV** dhe **SI**, procedura e përshpejtuuar aplikohet nëse ekzistojnë arsye të konsiderueshme për të besuar se aplikuesi përbën kërcënim ndaj rendit publik, sigurisë publike ose sigurisë kombëtare, ose është dëbuar me forcë për shkak të arsyeve të konsiderueshme se është kërcënim ndaj rendit publik, sigurisë publike ose sigurisë kombëtare. Në **SI**, zbatohen procedura të përshpejtuara edhe për fëmijët e pashoqëruar në rastin e përdorimit të konceptit të një vendi të sigurt origjine.

**CH** nuk është nën detyrimin e APD dhe nuk e zbaton atë. **BE, BG, IE** dhe **NL** nuk kanë dhënë informacion.

### Shembull nga praktika: Aplikimi i procedurave kufitare dhe atyre të përshpejtuara

Në **SI**, në procedurat kufitare, duhet të merret parasysh BIC. Procedurat e përshpejtuara aplikohen për fëmijët e pashoqëruar vetëm nëse:

- përdoret koncepti i vendit të sigurt të origjinës;
- ekzistojnë arsye të konsiderueshme për të besuar se aplikuesi paraqet kërcënim ndaj rendit publik, sigurisë publike ose sigurisë kombëtare;
- nëse aplikuesi është dëbuar me forcë për shkak të arsyeve të konsiderueshme për kërcënim ndaj rendit publik, sigurisë publike ose sigurisë kombëtare.

## Bërja dhe paraqitja e aplikimit nga ose në emër të fëmijës

### Fëmijët e shoqëruar

Në **AT, DE, ES, FR<sup>46</sup>, HU, LV, SE** dhe **SK**, aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare i një fëmije duhet të paraqitet nga prindi, kujdestari ose përfaqësuesi ligjor, ndërsa në **FI, EE, IT, LT, NO** aplikimi mund të paraqitet nga fëmijë.

<sup>40</sup> Procedurat kufitare dhe ato të përshpejtuara nuk aplikohen për fëmijët e pashoqëruar. Ato mund të aplikohen në rastet që kanë të bëjnë me fëmijët e ndarë.

<sup>41</sup> Vetëm procedurat kufitare.

<sup>42</sup> Procedura e përshpejtuuar nuk mund të aplikohet. Nuk ekziston asnjë procedurë kufitare në sistemin ligjor lituanes.

<sup>43</sup> Në **DE**, aplikohen procedura kufitare pas mbërritjes së personit me moshë të paqartë, derisa të konfirmohet mosha (procedura e pastrimit). Një procedurë e përshpejtuuar që aplikohet për fëmijët e pashoqëruar/të ndarë është ajo për vendet e sigurta të origjinës, dhe në parim, për aplikimet e mëpasshme ose në rastin e arsyeve serioze për tu konsideruar rrezik për sigurinë kombëtare ose rendin publik, ose aplikuesi është dëbuar me forcë për arsye serioze të sigurisë publike ose rendit publik.

<sup>44</sup> Në **FR**, procedurat kufitare aplikohen. Procedurat e përshpejtuara, vetëm kur fëmija është nga një vend i sigurt origjine; paraqet një aplikim pasues i cili nuk është i pranueshëm; ose konsiderohet kërcënim për sigurinë publike ose të shtetit.

<sup>45</sup> Në **HU**, procedurat kufitare nuk zbatohen për fëmijët e pashoqëruar. Procedurat e përshpejtuara mund të aplikohen për fëmijët e pashoqëruar nëse nuk përcaktohen asnjë nga kushtet.

<sup>46</sup> Në **FR**, nuk kanë kapacitet ligjor. Prandaj, ata nuk mund të bëjnë një aplikim për veten e tyre. Prandaj, prindërit aplikojnë për azil në rastet ku fëmijët janë të pranishëm në Francë dhe kjo përmendet në formularin e aplikimit të prindërve - edhe fëmijët pritet të jenë aplikues. Ose prindërit (përfaqësuesit ligjorë) nuk janë vetë aplikues por mund të bëjnë një aplikim në emër të fëmijës. Në secilin rast, fëmija nuk vepron vetë.

Në disa raste, në 14 shtete të BE+ (**BE**<sup>47</sup>, **BG** kur fëmija është mbi 14 vjeç me aprovimin prindëror, **CY**, **DK**, **EE**, **EL**, **FI**, **IE** ku i rrituri nuk është më aplikues, **IT**, **LT**, **NL**<sup>48</sup>, **NO**, **RO** dhe **SI**), fëmija ka kapacitetin të paraqitë një aplikacion për mbrojtje ndërkombëtare në emrin e tyre.

Në disa shtete të BE, merret parasysh mosha e fëmijës për të përcaktuar kapacitetin për të paraqitur aplikimin. Më poshtë janë disa shembuj të praktikës në shtetet e BE+ në lidhje me moshën që duhet të arrijë i mituri që të aplikojë vetë për mbrojtje ndërkombëtare:

<b>BG</b> +14 vjeç me aprovimin e	<b>EL</b> +15 vjeç	<b>NL</b> + 15 vjeç	<b>RO</b> +14 vjeç	<b>SI</b> +15 vjeç
--------------------------------------	-----------------------	------------------------	-----------------------	-----------------------

#### Shembuj nga praktika: aplikimi në emër të fëmijës

Në **BE**, duke filluar nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2018, Komisari i Përgjithshëm për Refugjatët dhe ish officio në emër të fëmijës së shoqëruar, kur është i mendimit se fëmija është në rrezik.

Në **CY**, fëmija ka kapacitetin të paraqesë aplikimin për veten e tij nëse kërkon që të ketë një aplikim të veçantë ose nëse funksionari mendon se kjo gjë është e përshtatshme sipas BIC. Vihen në dijeni Shërbimet e Mirëqenies Sociale.

#### Fëmijë të pashoqëruar

Në 15 shtete të BE+ (**AT**, **BE**, **BG**, **CH**, **DK**, **EL**, **FI**, **HU**, **IT**, **LT**, **LV**, **NL**, **NO**, **RO** dhe **SE**) fëmija i pashoqëruar ka kapacitetin ta paraqesë vetë aplikimin. Në **DK**, fëmija i pashoqëruar ka gjithnjë kapacitet, ndërsa në **BE**, **BG**, **CH**, **FI**, **HU**, **LT**, **LV** dhe **NO**, fëmija i pashoqëruar mund të paraqesë aplikim pa një përfaqësues nëse ka kapacitet të mjaftueshëm. Në shtete të tjera të BE+, merret parasysh mosha e fëmijës për të përcaktuar kapacitetin për të paraqitur aplikimin:

<b>AT</b> +14 vjeç*	<b>EL</b> +15 vjeç	<b>NL</b> +12 vjeç	<b>RO</b> +14 vjeç*
------------------------	-----------------------	-----------------------	------------------------

Marrëveshja e kujdestarit/konsulentit ligjor është kërkesë në **AT** (për fëmijët nën moshën 14 vjeç) dhe në **SE**, që fëmija aplikues të paraqesë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare.

Në **IT**, në rast se nuk është caktuar ende një kujdestar, një fëmijë i pashoqëruar mund të paraqesë një aplikim me ndihmën e drejtorit të qendrës së pranimit ku është strehuar.

Në **FR**, mund të ndodhë që aplikuesi nuk është identifikuar ende si i mitur dhe aplikuesit i është dhënë një formular aplikimi për ta paraqitur, ndërkohë që i mituri nuk ka kapacitet ligjor. Pas marrjes së këtij aplikimi, autoriteti përcaktues duhet ta paraqesë gjithsesi aplikimin sipas procedurës BIC dhe t'i kërkojë prokurorit publik që të caktojë një përfaqësues ligjor (*administrateur ad hoc*) për aplikuesin. Vlerësimi për aplikimit është në pritje derisa të caktohet përfaqësuesi ligjor.

Në **CY**, **DE**, **EE**, **ES**, **FR**, **IE**, **NL** (për fëmijët nën 12 vjeç), **PL**, **RO** (14 vjeç) **SI** dhe **SK**, fëmija i pashoqëruar nuk mund të paraqesë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare pa përfaqësues.

<sup>47</sup> Duke filluar nga gjashtëmujori i parë i vitit 2018, Komisari i Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi mund të vendosin të bëjnë një aplikim në emër të fëmijës së shoqëruar, kur Komisari i Përgjithshëm mendon se fëmija është në rrezik.

<sup>48</sup> Kërkesa që bëhet nga një i mitur mund të jepet në varësi të rrethanave individuale. Vini re se kërkesat për azil mund të miratohen gjithsesi duke u bazuar në kushtet që lidhen në mënyrë specifike me të miturin.

## Intervista personale

### Kur bëhet intervista

Intervista personale bëhet gjithnjë në **AT, BE**<sup>49</sup>, **BG, EL** (+15 vjeç), **FI** (+12 vjeç), **NL** (+15 vjeç), **NO, SE** dhe **SI** (+15 vjeç). Në **CH**, zakonisht fëmijët intervistohen personalisht (+14 vjeç).

Më në veçanti, në **BG** intervista bëhet për të përcaktuar BIC.

Në **BE** dhe **NO**, fëmija ka të drejtën e fjalës në të gjitha çështjet që lidhen me të.

Në **DE, EE** (mbi 10 vjeç), **ES** (12-14 vjeç), **FR, LT, NL** (nën 15 vjeç), **NO** (nëse fëmija dëshiron), **RO, SI** (nën 15 vjeç) dhe **SK**, intervista bëhet atëherë kur konsiderohet e nevojshme. Në **DE**, nëse fëmija është 6 deri në 13 vjeç, intervista bëhet vetëm nëse konsiderohet e nevojshme për të plotësuar deklaratën e prindërve dhe sipas kushtit që fëmija të jetë në gjendje të japë kontributin në mënyrë të efektshme.

Në **EE, LT** dhe **SI**, intervista personale bëhet nëse konsiderohet e nevojshme për procedimet. Në **NL**, vendimi për të bërë intervistën, si edhe nevoja që prindërit të jenë të pranishëm, bëhet rast pas rasti. Fëmijët e shoqëruar nuk intervistohen nëse janë nën 15 vjeç, përveç nëse është e nevojshme në rastet ku mund të ketë baza të pavarura për azil për fëmijën.

Në **CH** (nën 14 vjeç), **CY, DE, DK, EL** (nëse është nën 15 vjeç), **ES** (14-18 vjeç), **FR, HU, IE, IT, LV** dhe **PL**, intervista bëhet në rrethana të caktuara:

- Në **CY**, intervista bëhet vetëm nëse është e nevojshme në raste të jashtëzakonshme për BIC dhe me aprovimin e prindërve ose të të rriturit përgjegjës.
- Në **DE**, kur ekziston një situatë dhune në familje ose prindërit janë të përfshirë në gjymtimin gjenital të femrave (FGM) kundrejt fëmijës së tyre. Në këto raste, intervista bëhet edhe në rastet kur fëmija është nën 14 vjeç.
- Në **DK**, intervista bëhet në rastet e fëmijëve të ndarë<sup>50</sup>.
- Në **FR**, fëmija intervistohet vetëm nëse fëmija është qendra e arsyeve të familjes për azil; ose në rastet ku ekzistojnë tregues se fëmija mund të ketë arsye personale për mbrojtje ndërkombëtare, por prindërit nuk janë në dijeni të tyre. Fëmija do të intervistohet gjithashtu në rastet ku ekzistojnë tregues se prindërit mund të jenë të përfshirë si autorë ose bashkëpunëtorë në persekutim ose në shkaktimin e dëmeve serioze.
- Në **HU**, intervista bëhet në rastin e ribashkimit familjar, ndërsa në **IE**, fëmijët intervistohen nëse paraqesin një aplikim të veçantë. Në **PL**, varet nga dëshirat e prindërve ose të fëmijës (nëse e kërkojnë intervistën) ose nga vlerësimi i funksionarit të çështjes (nëse intervista konsiderohet e nevojshme).

## Fëmijët e shoqëruar

### Mosha minimale

Mosha minimale për të intervistuar një fëmijë të shoqëruar është një kërkesë në 10 shtete të BE+ (**CH, DE, EE, EL, ES, FI, FR, NL, NO** dhe **SI**). Sipas praktikës së shteteve të BE+, fëmija duhet të jetë:


- **CH**: mbi 14 vjeç;
- **DE**: nga 6-13 vjeç nëse është në gjendje dhe nëse nevojitet pas aprovimit të prindërve, nën 6 vjeç vetëm në raste të jashtëzakonshme, nga 14 vjeç nëse do të intervistohet rregullisht;
- **DK**: nëse fëmija ka arsyet e veta të aplikojë për azil ose nëse fëmija shoqërohet nga një i rritur, përveç prindërve;
- **EE**: mbi 10 vjeç;
- **ES, FI** dhe **FR**: mbi 12 vjeç

<sup>49</sup> Duke filluar nga gjashtëmujori i parë i vitit 2018, çdo fëmijë të shoqëruar do t'i jepet e drejta e fjalës, siç parashikohet në ligjin e ri për të huajt.

<sup>50</sup> Fëmijët e shoqëruar nga një pjesëtar i rritur i familjes, i cili nuk është prind i tyre.

- në **EL, NL** dhe **SI** mbi 15 vjeç. Në **EL** intervista mund të bëhet nën 15 vjeç në varësi të moshës dhe pjekurisë së fëmijës; ndërsa në **NL** vetëm nëse është e nevojshme në rastet e bazave të pavarura
- në **NO**, 7 vjeç ose më pak nëse fëmija është i pjekur

**Figura 5: Moshë minimale për intervistimin e fëmijëve të shoqëruar**



Në 12 prej shteteve të BE+ (**AT, BE, CY, DK, HU, IE, IT, LT, LV, PL, SE** dhe **SK**) nuk ekziston asnjë kërkesë minimale për moshën që fëmija të intervistohet.

**BG** dhe **RO** nuk kanë specifikuar nëse nevojitet një moshë minimale që fëmija të intervistohet.

### *Intervista e përshtatshme për fëmijë*

Në disa shtete të BE+ (**AT, EL** (nëse është më pak se 15 vjeç), **HU, IE, RO** dhe **SK**), merret parasysh pjekuria e fëmijës për të përcaktuar nëse duhet të bëhet një intervistë.

#### **Shembuj nga praktika: pjekuria gjatë intervistës**

Në **AT**, autoriteti duhet t'i përshtasë pyetjet sipas pjekurisë intelektuale të fëmijës në kohën që bëhet intervista.

Në **CY**, autoritetet bëjnë një vlerësim individual të secilit rast për të vendosur nëse një fëmijë duhet të intervistohet ose jo.

Në **RO**, për shembull, funksionari i mbrojtjes duhet të vendosë nëse duhet ta intervistojë fëmijën duke pasur parasysh BIC dhe në varësi të nivelit të pjekurisë, si edhe të kuptueshmërisë dhe fazës së zhvillimit të fëmijës në atë kohë.

Një stafi të trajnuar në mënyrë të veçantë i caktohet detyra për të intervistuar fëmijët e shoqëruar në **DE** (në rastin kur janë më të rrezikuar), **DK** (në rastin e intervistave veçmas nga prindërit), **FR** (në rastet ku intervista me fëmijën konsiderohet e nevojshme), **IT, NL, NO**, dhe **PL**.

Përveç kësaj, fëmijës së shoqëruar i caktohet një konsulent ligjor në **BG, DK** (kur aplikimi për azil konsiderohet i pabazë, ose kur vendimi negativ do të shqyrtohet nga Bordi Danez për Refugjatët), **LT, NL** dhe **SK** (nëse kërkohet nga prindi/kujdestari).

### *Roli i prindërve ose i të rriturit përgjegjës për fëmijën e shoqëruar*

Prindërit/kujdestari duhet të jetë i pranishëm gjatë intervistës personale në 14 prej shteteve (**AT, BG, CH, CY, DE, FI, FR**<sup>51</sup>, **IE, IT**<sup>52</sup>, **LT, NO, PL, SI** dhe **SK**). Në **IE**, do të jenë të pranishëm gjatë intervistës vetëm nëse

<sup>51</sup> në rastin e arsyeve personale të ditura për familjen

<sup>52</sup> përveç nëse bëhen intervista veçmas për BIC

fëmija e kërkon shprehimisht, ose në rastet në të cilat fëmijët më të vegjël janë gjithashtu në gjendje të përgjigjen në emër të fëmijës.

Përfaqësuesi ligjor/avokati i fëmijës duhet të jetë i pranishëm në rast se intervista bëhet në **AT, EE, LT** dhe **SI**. Në mënyrë specifike, në **LT** përfaqësuesi ligjor i prindërve caktohet në rast se është e nevojshme për të bërë intervistën në mungesë të prindërve të fëmijës. Në **SI**, përfaqësuesi ligjor duhet të jetë i pranishëm gjatë intervistave personale që bëhen me fëmijë nën 15 vjeç.

Përndryshe, autoritetet bëjnë një **intervistë veçmas** me fëmijën e shoqëruar në 15 shtete të BE+ (**BE**<sup>53</sup>, **CY, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IT, LV** (përveç nëse nevojitet prania e prindërve), **NL** (mbi 15 vjeç)<sup>54</sup>, **PL** dhe **SE**.

Në **BE, DK** (nëse është i shoqëruar nga një i rritur tjetër përveç prindërve, ose nëse fëmija ka arsyet e veta që të paraqesë një aplikim), dhe **NL** (mbi 15 vjeç), intervista do të bëhet gjithnjë veçmas, ndërsa në 12 vendet e tjera ndryshon në varësi të rrethanave:

- Në **CY**, fëmija intervistohet vetëm ose në praninë e prindërve, në varësi të faktit se si ndihet më rehat.
- Në **DE**, në rastet e dhunës në familje ose nëse prindërit janë përfshirë në FGM ndaj fëmijës së tyre, fëmija ndahet nga prindërit e tij gjatë intervistës. Në këto raste, mund të bëhet gjithashtu një intervistë personale edhe nëse fëmija është nën 14 vjeç ose prindërit nuk janë dakord me intervistën personale.
- Në **EL**, në parim, fëmijët e shoqëruar mbi 15 vjeç intervistohen veçmas në shumicën e rasteve. Në varësi të moshës, pjekurisë dhe rrethanave të tyre personale, mund të intervistohen edhe fëmijët nën moshën 15 vjeç. Intervista mund të bëhet pa praninë e prindërve ose të përfaqësuesit ligjor/avokatit.
- **FR** bën një intervistë veçmas në rastet ku ka tregues se prindërit mund të mos jenë në dijeni të persekutimit ose dëmtimit serioz, ose se mund të jenë të përfshirë si autorë a bashkëpunëtorë të persekutimit ose dëmtimit serioz.
- Në **FI** dhe **PL**, fëmija mund të intervistohet veçmas pas aprovimit të prindërve/kujdestarëve.
- Në **HU**, intervista veçmas e fëmijës bëhet në rast se ka konflikt interesi dhe në **IT** nëse kërkohet ose rekomandohet për BIC ose nëse kërkohet nga fëmija.
- Në **SE**, bëhet një vlerësim për të vendosur nëse është e përshtatshme që fëmija të intervistohet pa praninë e prindërve ose të të rriturit përgjegjës.

#### Shembuj nga praktika: intervista veçmas

**NO:** Fëmija ka të drejtën e fjalës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta. UDI ofron intervistë/bisedë me një funksionar të çështjes për të gjithë fëmijët mbi moshën shtatëvjeçare (ose më të vegjël nëse janë të pjekur). Prindërit nuk mund t'i mohojnë fëmijës të drejtën që të dëgjohet. Zakonisht, një nga prindërit ose një person tjetër që ushtron përgjegjësi prindërore do të jetë i pranishëm gjatë intervistës. Gjithashtu fëmija mund të intervistohet veçmas (edhe pse me një kujdestar të caktuar të pranishëm) nëse fëmija dëshiron, ose nëse ka arsye për të menduar se ekziston një konflikt interesi mes fëmijës dhe prindërve.

Në **SK**, nëse i mituri nuk dëshiron ta bëjë intervistën në praninë e prindërve ose të të rriturit përgjegjës, do të caktohet një i rritur ad litem.

#### Transkripti/raporti i intervistës

Në 19 shtete të BE+ (**AT, BG, CH, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IE, IT, LT, NO, PL, RO, SI** dhe **SK**), transkripti i intervistës personale ndahet me prindërit ose me të rriturin përgjegjës. Megjithatë, në 13 prej tyre (**CH, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IE**<sup>55</sup>, **LT, NO**<sup>56</sup>, **RO, SI**), aplikohen përjashtime ndaj këtij rregulli të përgjithshëm. Për shembull, në **CH, DK** dhe **ES**, transkripti do të ndahet, përveç nëse fëmija nuk është dakord. Në **EE**

<sup>53</sup> Duke filluar nga gjashtëmujori i parë i vitit 2018, prindërit nuk mund të jenë më të pranishëm gjatë intervistës së fëmijës së tyre të shoqëruar.

<sup>54</sup> Nën moshën 15, prania e prindërve gjatë intervistës vendoset në varësi të çdo personi.

<sup>55</sup> Kopje të shënimeve të intervistës i jepen aplikuesit/kujdestarit dhe përfaqësuesit ligjor të tij, së bashku me raportin e ekzaminimit të kërkesës në rastet kur rekomandimi është negativ. Shënimet e intervistës nuk jepen menjëherë pas intervistës.

<sup>56</sup> Përjashtime ndaj rregullit të përgjithshëm zbatohen nëse UDI, për shembull, nuk pranon të ndajë informacionin e intervistës, nëse ka arsye të vlefshme për të menduar se informacioni mund të ndikojë negativisht te sjellja e prindit në lidhje me fëmijën ose mund të ndikojë te marrëdhënia mes tyre.

dhe **RO**, do të ndahet nëse është në BIC. Në **EL**, transkripti nuk ndahet nëse fëmija është mbi 15 vjeç dhe ka paraqitur një aplikim të veçantë për mbrojtje ndërkombëtare. Në **HU** dhe **SI**, transkripti i intervistës nuk ndahet me prindërit ose me të rriturin përgjegjës, në rastet e konflikteve të interesit ose, në mënyrë specifike në **SI**, nëse ndarja e informacionit nuk përputhet me BIC.

Transkripti i intervistës së fëmijës nuk ndahet me prindërit ose përfaqësuesit ligjorë në **BE**<sup>57</sup>, **CY**, **LV**, **NL** dhe **SE**<sup>58</sup>.

#### Shembuj nga praktika: transkripti/raporti i intervistës

Në **DK**, fëmija pyetet gjithnjë nëse janë dakord që prindërit ta lexojnë përmbledhjen e intervistës me Shërbimin Danez për Emigracionin ose nëse ka ndonjë pjesë specifike e përmbledhjes që nuk duhet ta shohin.

Në **FI**, transkripti i intervistës mbetet sekret në rast se fëmija zbulon gjëra që prindërit nuk duhet ta dinë, p.sh. për arsye sigurie në rastet e abuzimit. Në këto raste, mund të bëhet një raport i veçantë.

### Fëmijë të pashoqëruar

#### Mosha minimale

Për sa i përket kërkesës për moshën minimale, vetëm dy shtete kanë raportuar kufij moshe për intervistimin e fëmijëve të pashoqëruar: **DE** (rregullisht nga mosha 14 vjeç, të miturit 6-13 vjeç nëse janë në gjendje dhe nëse është e nevojshme pas aprovimit të prindërve, nën 6 vetëm në raste të jashtëzakonshme), dhe **NL** (mbi 6 vjeç).

#### Intervista e përshtatshme për fëmijë

Disa prej përgjigjeve (12 shtete BE+) raportuan për përdorimin e teknikave të intervistimit të përshtatshme për fëmijë për të ndihmuar fëmijët e pashoqëruar të bënin aplikimin e tyre. Këto shtete të BE+ **AT** (gjuha e përshtatshme për fëmijë e përshtatur sipas pjekurisë së fëmijës), **DE**, **DK** (nëse fëmija nuk konsiderohet i pjekur, më shumë të ngjarë nën moshën 12 vjeç, intervista bëhet e shkurtër), **EL**, **FI** (më shumë kohë u jepet fëmijëve për intervistën personale), **FR**, **IE**, **IT**, **NL** (në rastin e fëmijëve nën moshën 12 vjeç), **LV**, **NO** (më shumë kohë për intervistën), dhe **SK**.

Për sa i përket vendndodhjes së intervistës, fëmijët intervistohen në qendrën e kujdesit ku strehohen në **PL** dhe në **NO** (nëse janë nën 12 vjeç ose nëse kanë më shumë se 2 orë udhëtim).

Fëmijët e pashoqëruar intervistohen nga stafi i posaçëm i trajnuar në **AT**, **BE**, **CY**, **DE**, **DK**, **EL**, **FI**, **FR**, **IE**, **LV**, **NL** dhe **PL**. Ekziston gjithashtu mundësia për t'u ndihmuar fëmijëve duke caktuar një konsulent ligjor në **BE**, **BG** (nëse është e nevojshme), **CY** (këshilla ligjore falas), **DK** (nëse aplikimi është i pabazë ose kur vendimi negativ do të shqyrtohet nga Bordi Danez për Refugjatët), **ES** (në rastin e një interviste sipas procedurës kufitare), **FR**, **NO** (avokat), **SE** dhe **SK** (nëse kërkohet).

#### Roli i kujdestarit dhe/ose përfaqësuesit për fëmijën e pashoqëruar

Kujdestari/përfaqësuesi i fëmijës ka rol aktiv gjatë intervistës personale në 22 shtete të BE+ (**AT**, **BE**, **BG**, **CH**, **CY**, **DE**, **DK**, **EE**, **EL**, **ES**, **FI**, **FR**, **HU**, **IE**, **IT**, **LT**, **LV**, **NO**, **PL**, **RO**, **SI** dhe **SK**). Në **SE** dhe **NL**, kujdestari/përfaqësuesi nuk ka rol aktiv gjatë intervistës. Në veçanti, në **NL**, nëse fëmija është nën 12 vjeç, kujdestari është i pranishëm jashtë dhomës së intervistës. Ai e sheh intervistën nëpërmjet ekranit.

Roli i kujdestarit/përfaqësuesit ndryshon në varësi të shtetit. Rolet kryesore që ka kujdestari/përfaqësuesi gjatë intervistës janë:

⇒ Përgatit fëmijën për intervistën në **AT**, **BE**, **DE**, **DK**, **NO** dhe **SK**;

<sup>57</sup> Duke filluar nga gjashtëmujori i parë i vitit 2018, prindërit nuk mund të kenë më dosjen e fëmijës së tyre nëse nuk është BIC.

<sup>58</sup> Përveç nëse kërkohet nga prindërit/përfaqësuesi ligjor



- ⇒ Është i pranishëm në **AT, BE, CY, DE, DK, FR, NL** (fëmijë +12 vjeç)<sup>59</sup> **NO, SE** dhe **SK**;
- ⇒ Jep ndihmë në **AT, BE, BG, CH, CY, DE, DK, ES, FI, FR, IE, IT, NO, SE** dhe **SK**;
- ⇒ Bën pyetje në **AT** (dhe paraqit aplikimet) **CH, DE, ES, FR, HU, LT, PL, SI** dhe **SK**;
- ⇒ Jep informacion shtesë dhe/ose bën komente në **AT, DE, DK, EL, HU, FR, IT, LT, LV, NO, SI** dhe **SK**;
- ⇒ Siguron BIC në **AT, BG, DE, DK, EE, HU, LT, NO, SI** dhe **SK**;
- ⇒ Siguron respekt për të drejtat e fëmijës në **AT, BG, DE, DK, HU, IE, IT, PL, RO, SI** dhe **SK**;
- ⇒ Merret mendimi i tij para se të merret vendimi në **AT, DK** dhe **SE**<sup>60</sup>
- ⇒ Ushtron kapacitet ligjor në **DE, FR, NO, SE** (jep aprovimin për disa masa);
- ⇒ Paraqit aplikime në **AT, DE, FR**, dhe **SK**.

#### Shembuj nga praktika: roli i kujdestarit/përfaqësuesit gjatë intervistës

Në **DK**, merret mendimi i përfaqësuesit personal para se të merren vendime për pjekurinë ose transferimin në vende të tjera. Po kështu, përfaqësuesi mund të komentojë për transkriptin, por nuk merret vendimi i tij para se të merret vendimi përfundimtar për çështjen e azilit

Në **LV**, nuk ka rregulla specifike që përkufizojnë rolin e kujdestarit/përfaqësuesit ligjor gjatë intervistës. Në praktikë, ai është pjesëmarrës aktiv dhe mund të bëjë pyetje ose të japë vërejtje për intervistuesin në rast se mendon se BIC nuk është respektuar.

#### Roli i bashkëshortit në rastin e një fëmije të martuar

Në rastin e fëmijëve të martuar, **bashkëshorti i rritur** mund të marrë pjesë në intervistën personale me fëmijën në shtete të BE+ (**AT, BE, DK, ES, HU, IE** (nëse i rrituri nuk është gjithashtu një aplikues), dhe **IT**). Megjithatë, në të gjitha shtetet, bashkëshorti i rritur duhet të plotësojë disa kërkesa që të marrë pjesë në intervistë. Prandaj, në **AT, HU** dhe **IT**, vetëm bashkëshorti që është caktuar si përfaqësues ligjor/kujdestar i fëmijës lejohet të jetë i pranishëm gjatë intervistës. Në **BE**, martesë duhet të konsiderohet martesë ligjore dhe fëmija duhet të jetë mbi 16 vjeç. Në **DK**, kërkohet aprovimi i fëmijës. Në **IE**, bashkëshorti nuk mund të jetë aplikues; përndryshe nuk do të ishte në gjendje të merrte pjesë në intervistë, ndërsa në **ES** varet nga vlerësimi i fëmijës dhe mosha.

Në **HU**, fëmija intervistohet për të parë nëse ka abuzime të mundshme ose konflikte interesi.

Në 14 shtete të BE+ (**BG, CH, CY, DE** (në përgjithësi), **EE, EL** (në parim), **IE** (kur i rrituri është gjithashtu aplikues), **FI, FR, NL, NO** (në përgjithësi), **PL, SE** dhe **SI**) bashkëshorti nuk mund të marrë pjesë te intervista personale. Në mënyrë specifike, në **NL**, azilkërkuesi konsiderohet fëmijë i pashoqëruar pasi martesë nuk njihet, dhe për këtë arsye, fëmija intervistohet veçmas nga i rrituri dhe për të merret një vendim më vete.

Vendime të veçanta jepen në **BE, BG, CH, CY, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IE, IT, NL, NO, PL, SE** dhe **SI**. Aplikohen përjashtime në shtetet e mëposhtme:

- **AT**, nëse bashkëshorti i rritur është përfaqësues ligjor, vendimi i jepet përfaqësuesit ligjor;
- **ES**, varet nga vlerësimi dhe mosha e fëmijës;
- **HU**, kur i rrituri pranohet si përfaqësues ligjor dhe ka një aplikim të përbashkët;
- **SI**, kur fëmija dhe bashkëshorti aplikojnë në të njëjtën situatë dhe u referohen të njëjtave fakte.

**LT, LV, RO** dhe **SK** nuk kanë dhënë informacion për këtë aspekt.

<sup>59</sup> Kujdestari ka rol pasiv. Ai e sheh intervistën nga jashtë dhomës së intervistës nëpërmjet një ekrani nëse fëmija është nën 12 vjeç.

<sup>60</sup> Kujdestari ka rol pasiv gjatë intervistës. Sidoqoftë, në disa raste, kujdestari përfshihet në dhënien e aprovimit për disa masa të caktuara, si për shembull vlerësimi i moshës.

## Garanci procedurale shtesë dhe kushte të veçanta pranimi për fëmijët

### ➤ Shënim për terminologjinë

Garancitë procedurale janë masa ndihme specifike për të krijuar kushtet që duhen për personat me nevoja të veçanta, që të kenë qasje në procedura, dhe paraqesin elementët e nevojshëm për të provuar aplikimin e tyre për mbrojtje ndërkombëtare.

Ato u japin mundësi aplikuesve me nevoja të veçanta që të nxjerrin dobi nga të drejtat e tyre dhe t'i përmbahen detyrimeve që kanë sipas APD (ndryshim) (recitali 29 dhe pika 2(d)).

Disa garanci të tjera procedurale dhe kushte të veçanta pranimi për fëmijët, të nxjerra nga konsultimi, janë:

FËMIJËT E SHOQËRUAR	FËMIJË TË PASHOQËRUAR
⇒ Dëgjohen mendimet e fëmijës në <b>DK</b> (i shoqëruar nga të rritur të tjerë, përveç prindërve), <b>LV</b> , <b>NO</b> dhe <b>SI</b> .	⇒ Dëgjohen mendimet e fëmijës në <b>AT</b> , <b>DK</b> dhe <b>NO</b> .  ⇒ Përgatitjet dhe sigurimi i informacionit: Fëmijëve u jepet më shumë kohë të pushojnë dhe të përgatiten para se të fillojë procedura e azilit në <b>FR</b> (përveç nëse duhet t'i jepet prioritet, vendimi njoftohet sa më shpejt të jetë e mundur pas intervistës, përveç nëse kërkohet ndryshe për vlerësimin e aplikimit), <b>NL</b> dhe <b>SE</b> . Në <b>AT</b> , <b>CY</b> , <b>DK</b> , <b>FR</b> (është krijuar një fletëpalosje e veçantë për aplikuesit fëmijë të pashoqëruar për të shpjeguar procedurën e azilit në një mënyrë të përshtatshme për fëmijët) dhe <b>SE</b> , fëmijët informohen për fazat e procedurës së azilit, ndërsa në <b>AT</b> , <b>DK</b> , <b>IE</b> , <b>FR</b> dhe <b>NO</b> ata marrin informacion se si të apelojnë në rast refuzimi.
⇒ Ribashkimi familjar i shqyrtuar/mundësuar: <b>SI</b> .	⇒ Gjurmimi i familjes <sup>61</sup> : <b>AT</b> , <b>DE</b> (brenda procedurës së Dublinit), <b>DK</b> , <b>NO</b> (nëse është e mundur), <b>SE</b> , <b>SI</b> dhe mundësitë e ribashkimit familjar në një shtet të Dublinit: <b>AT</b> , <b>CY</b> <sup>62</sup> , <b>DE</b> , <b>DK</b> , <b>SE</b> .

<sup>61</sup> Kërkimi për pjesëtarët e familjes (duke përfshirë të afërmit ose ish kujdestarët e fëmijëve të pashoqëruar) me qëllimin e restaurimit të lidhjeve familjare dhe ribashkimit familjar, kur kjo është në interesat më të mira të fëmijës. Shiko gjithashtu EASO, [Udhëzim praktik për gjurmimin e familjes](#), mars 2016.

<sup>62</sup> Në procedurën e Dublinit

<sup>63</sup> Si edhe person i besuar nëse fëmija ka dëshirë.

FËMIJËT E SHOQËRUAR	FËMIJË TË PASHOQËRUAR
<ul style="list-style-type: none"> <li>⇒ Këshillimi mjekësor dhe/ose psikologjik</li> <li>⇒ <b>BG</b> (nëse është e nevojshme), <b>DK</b> (të gjithë fëmijëve u ofrohet kontrolli psikologjik/mjekësor. Nëse është e nevojshme, aplikuesve do t'u ofrohet trajtim/këshillim i mëtejshëm mjekësor/psikologjik), <b>FR</b> (çdo aplikues që vuan nga ndonjë sëmundje mendore, mund të kërkojnë që profesionisti i kualifikuar i shëndetit mendor të ketë mundësi të marrë pjesë në intervistë si vëzhgues pasiv. Kërkesa miratohet në varësi të çdo rasti), <b>PL</b> (për intervistën), <b>SI</b> dhe <b>SK</b> (nëse është e nevojshme).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>⇒ Këshillimi mjekësor dhe psikologjik (*nëse është e nevojshme): në <b>AT</b>, <b>BG*</b>, <b>DE*</b> (nëse kërkohet nga zyra për mirëqenien e të rinjve), <b>FR</b>, <b>IT*</b>, <b>PL</b><sup>63</sup>, <b>SI</b> dhe <b>SK*</b></li> <li>⇒ Rrethana të veçanta, si mosha, trauma, pjekuria, gjendja mjekësore, shqyrtohen plotësisht nga funksionari i çështjes në <b>AT</b>, <b>DE</b>, <b>DK</b>, <b>FR</b> dhe <b>IE</b>.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>⇒ Akomodimi special për familjet</li> <li>⇒ <b>NL</b>, <b>SI</b> dhe <b>SK</b></li> <li>⇒ Asnjë ndalim për më shumë se 30 ditë dhe vetëm në rast se është zgjidhja e fundit për familjet me fëmijë <b>HU</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>⇒ Fëmijët nën moshën 15 vjeç vendosen në familje kujdestarie në <b>NL</b>, dhe nën përgjegjësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në <b>NO</b>.</li> <li>⇒ Fëmijët mund të paraqesin aplikim në cilindo rajon policie dhe nuk janë të detyruar të shkojnë vetë te qendra e pranimit në <b>AT</b> dhe <b>NL</b>.</li> <li>⇒ Fëmijët nuk janë të detyruar të shkojnë vetë tek autoriteti për azilin - ata shoqërohen nga autoriteti zbulues në <b>SE</b>.</li> <li>⇒ Akomodim me staf me trajnim të posaçëm në <b>AT</b>, <b>DK</b>, <b>NL</b>, <b>SE</b>, <b>SI</b> dhe <b>SK</b>.</li> <li>⇒ Fëmijët e pashoqëruar nuk mund të vendosen nën ndalim në <b>SE</b> dhe <b>SI</b>. Në <b>AT</b> (vetëm për fëmijët nën moshën 16).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>⇒ Aktivitetet e kohës së lirë të siguruar: <b>SI</b></li> <li>⇒ Garancitë do të bazohen në një analizë rast pas rasti: <b>BG</b>, <b>CY</b> (me kërkesën e një funksionari kompetent, përndryshe asnjë praktikë specifike), <b>NL</b>, <b>SI</b></li> <li>⇒ Direktiva dhe procedura të veçanta për fëmijët: <b>FR</b>, <b>NO</b></li> <li>⇒ Të gjitha garancitë e aplikuara për njerëzit e rrezikuar: <b>ES</b>, <b>FR</b></li> <li>⇒ Të gjitha garancitë nga direktiva e azilit: <b>RO</b></li> <li>⇒ Garancitë sipas CRC: <b>CH</b></li> <li>⇒ Nuk ofrohet asnjë garanci: <b>EL</b> (kur janë të shoqëruar)</li> <li>⇒ Nuk ka dhënë informacion: <b>BE</b></li> </ul>	

## Seksioni 4. Referimi

### ➤ Shënim për terminologjinë

Për qëllim të këtij raporti, mekanizmat e referimit janë kuadrot bashkëpunuese që kanë si synim identifikimin, mbrojtjen dhe asistimin e fëmijëve nëpërmjet referimit në kohë të ndihma e duhur dhe duke përfshirë autoritetet përkatëse publike dhe shoqërinë civile.

Ky seksion tregon mekanizmat ekzistues të referimit dhe rrethanat që do t'i aktivizonin ato.

Në 14 prej shteteve (**AT, BE, CY, EE, ES, FI, IE, IT, NL, NO, PL, RO, SE** dhe **SI**) ekziston një protokoll për bashkëpunimin me autoritetet e mbrojtjes së fëmijëve.

Në **ES**, pasi policia vihet në dijeni për situatën (e cila normalisht ndodh pasi aplikuesi mbërrin në territorin spanjoll në kufi), ajo kontakton menjëherë prokurorin publik. Prokurori publik është përgjegjës për koordinimin e mbikëqyrjes së fëmijës, së bashku me entet publike të mbrojtjes së të miturve që do të caktohen si kujdestarë.

Në **FR**<sup>64</sup>, **DK**, **EL** dhe **SK**, bashkëpunimi rregullohet sipas legjislacionit kombëtar, ndërsa në **CH**, ekzistojnë disa rekomandime nga drejtuesit socialë të kantoneve dhe të implementuara nga kantonet.

Në **HU** dhe **DE**, mbahen rregullisht takime me autoritetin e mbrojtjes së fëmijëve për të siguruar bashkëpunimin. Në **DE**, zyra federale takohet rregullisht me Shoqatën Federale për të Miturit e Pashoqëruar për të diskutuar për pyetje të përgjithshme lidhur me fëmijët e pashoqëruar. Shoqata është gjithashtu pjesë e moduleve të trajnimit lidhur me fëmijët e pashoqëruar.

Nuk ka protokolle ose rekomandime në **BG**<sup>65</sup>, **LT** dhe **LV**.

### Referimi tek autoritetet e tjera

Për sa i përket referimit të autoritetet e mbrojtjes së fëmijëve ose ofruesit e shërbimeve, për ndihmë të mëtejshme të fëmijëve që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, autoritetet do ta referojnë fëmijën në situatat e mëposhtme:

- ⇒ Zhdukja e fëmijëve në **BG, EL, NO** dhe **PL**
- ⇒ Tregues të trafikimit a abuzimit ose të një fëmije në rrezik në **AT, BG, DE, DK, EL, FI, FR, IE, LV, LT, NO, PL, SE** dhe **SI**
- ⇒ Nëse fëmija zbulohet se është i pashoqëruar, në **BE, CY, EL, ES, FR, HU, IE, NL, SI** (nëse është shumë i vogël) dhe **SK**
- ⇒ Nëse fëmija ka nevoja të veçanta të tjera në **DE**<sup>66</sup>, **IT, LT, NO** dhe **SI** (nëse është në moshë të vogël)
- ⇒ Nëse i rrituri shoqëruar nuk është i përshtatshëm, në **IE** dhe **NO**
- ⇒ Për vlerësimin e BIC në rastin e fëmijëve të pashoqëruar në **CY**
- ⇒ Në rastin e kërkesës për informacion të mëtejshëm për situatën e fëmijës, në **CH**
- ⇒ Bazuar në një analizë rast pas rasti, në **EE** dhe **RO** për BIC
- ⇒ Kur funksionari i çështjes e sheh të nevojshme, në **LT** dhe **NO**

<sup>64</sup> Po diskutohen protokolle vendëse në lidhje me çështjet e trafikimit të fëmijëve.

<sup>65</sup> Për t'u adoptuar: një mekanizëm koordinimi për bashkëveprim mes institucioneve dhe organizatave në rastin e fëmijëve të pashoqëruar ose fëmijëve të huaj të ndarë nga familjet e tyre, të cilët ndodhen në territorin e Republikës së Bullgarisë, duke përfshirë fëmijët që kërkojnë dhe/ose kanë marrë mbrojtje ndërkombëtare.

<sup>66</sup> Shërbimi për mirëqenien e të rinjve është përgjegjës për fëmijën në çfarëdo situatë rreziku ku prindërit ose kujdestarët nuk veprojnë në të mirën e tyre.

**Shembuj nga praktika: referimi te autoritetet kompetente dhe ndihma**

Në **BE**, fëmijët e pashoqëruar nën moshën 12 vjeç, të cilët pranohen për kujdestari, do të marrin këtë kujdes nëpërmjet një procedure të përshpejtuar. Përveç kësaj, në disa raste, ndihma që u jepet fëmijëve të pashoqëruar në BE mund të zgjatë derisa të jenë 21 ose 25 vjeç.

Në **DK**, nëse ka tregues të abuzimit, trafikimit të qenieve njerëzore ose abuzimit prindëror, mund të konsultohen autoritetet përkatëse. Mund të jetë i nevojshëm aprovimi nga fëmija.

## Procedurat nëse fëmija humb, ka shenja të trafikimit ose abuzimit, në rastet e aftësive të kufizuara, problemeve me shëndetin, shtatzëninë ose çështje të tjera.

Autoritetet e ndryshme përfshihen në proces dhe në gradë tjetër. Një sintezë e atyre procedurave është si më poshtë:

### Kur fëmija humb<sup>67</sup>

Përfshihen autoritetet e mëposhtme dhe ato janë përgjegjëse për veprimet kryesore që janë shënuar me yllth (\*):

- ⇒ autoriteti për azilin në **CY, DK\*, FI, NO, SE** dhe **SK**;
- ⇒ autoritetet e pranimi në **AT, BE, FI\*, LT, NL, NO, SE, SI** dhe **SK**;
- ⇒ autoritetet për mirëqenien sociale (shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve) në **AT\*, CY\*, DE\*, EL, FR, HU, IE\*, NL\*** dhe **SE**;
- ⇒ policia në **AT\*, BE\*, BG\*, DK\*, EL, FR\*, HU\*, LT\*, NL, NO, PL\*, SE, SI \*** dhe **SK\***;
- ⇒ prokurori publik në **AT\*** dhe **EL**;
- ⇒ Gjykata dhe kujdestari në **SK\***;
- ⇒ Qendra e akomodimit, përfaqësuesi ligjor në **SI**.<sup>68</sup>

A) ZHDUKJA E FËMIJËS (Përfshihen autoritetet e mëposhtme):					
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimi	Autoritetet për mirëqenien sociale (shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve)	Aktorë të tjerë	Policia
<b>AT</b>		√	√ Mirëqenia e të rinjve*	√* Prokurori publik nëse është një krim i mundshëm	√ *Departamenti i hetimit kriminal nëse është krim i mundshëm
<b>BE</b>		√ Protokolli me policinë <sup>68</sup>			√ *Protokolli me qendrën e pranimi
<b>BG</b>					√ *Informohet Njësia Territoriale e Ministrisë së Brendshme

<sup>67</sup> Në shtetet anëtare të shënuara me yllth, autoritetet e përfshira e ndajnë përgjegjësinë për ndërmarrjen e hapave/veprimeve të para.

<sup>68</sup> Nëse një fëmijë i pashoqëruar zhduket (humb) nga një vend pranimi në **BE**, kjo i sinjalizohet policisë lokale (menjëherë nëse zhdukja është "shqetësuese"; nëse jo, pas 24 orësh). Nëse zhdukja është shqetësuese, prokuroria mund t'i kërkojë Child Focus që të marrë masa. Aktualisht, ekziston një protokoll i caktuar bashkëpunimi mes policisë në zonën ku ndodhet një prej qendrave të pranimi për fëmijët e pashoqëruar dhe qendrës. Kjo shërben si pikë fillestare për një nismë kombëtare.

A) ZHDUKJA E FËMIJËS (Përfshihen autoritetet e mëposhtme):					
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimit	Autoritetet për mirëqenien sociale (shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve)	Aktorë të tjerë	Policia
CH	Bashkëpunimi me autoritetet kompetente (kantonale) (p.sh. autoritetet e prokurorisë, autoritetet kantonale për mbrojtjen e fëmijëve, OJQ-të, etj)				
CY	√ Identifikon çështjen		√*		
DE	√ *Shërbimet për mirëqenien e të rinjve				
DK	√* Shërbimi Danez për Emigracionin regjistron zhdukjen				√*
EE	Rastet procesohen rast pas rasti. Ekzistojnë direktiva specifike për fëmijët që shfaqin shenja trafikimi ose abuzimi.				
EL			√ Qendra Kombëtare për Solidaritetin Social	√ Prokurori publik	√ departamenti kompetent i policisë
ES	Të miturit e pashoqëruar trajtohen si të rrezikuar				
FI	√ Kontakti me njësinë e pranimit	√*			
FR	√ Informimi i policisë				
HU			√ Informon policinë kur fëmija mungon për më shumë se 24 orë		√*
IE	√* TUSLA do të informohet				
IT <sup>69</sup>					
LT	√ Informon policinë				
LV	Në të gjitha rastet, autoritetet e përfshira në procedurën e azilit duhet të veprojnë sipas ligjit. Deri tani nuk janë krijuar procedura specifike.				
NL		√ Nëse ekzistojnë tregues rreziku, vendoset në strehim të mbrojtur me më shumë siguri dhe mbikëqyrje	√ (Informohet NI-DOS*)		√ Policia dhe Qendra Eksperte për Trafikimin e Qenieve Njerëzore* informohen për zhdukjen, dhe policia informohet për rreziqet shtesë

<sup>69</sup> Nuk jepet informacion specifik.

A) ZHDUKJA E FËMIJËS (Përfshihen autoritetet e mëposhtme):					
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimit	Autoritetet për mirëqenien sociale (shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve)	Aktorë të tjerë	Policia
<b>NO</b>	√*	√*			√*
<b>PL</b>					√*
<b>RO</b> <sup>70</sup>					
<b>SE</b>	√ SMA u raporton autoriteteve të tjera	√	√		√
<b>SI</b>		√		√ Institucioni ku akomodohet fëmija, përfaqësuesi ligjor	√*
<b>SK</b>	√ Zyra e emigracionit)*	√ Jetimorja do të informojë autoritetet e tjera		√ gjykata* / kujdestari*	√*

#### Shembuj nga praktika: referim në rastin e zhdukjes ose rrezikut të zhdukjes

Në **NL**, nëse ekziston një tregues ose dyshim i vërtetë për nisje të parakohshme dhe/ose që të ndodhë një situatë e dyshimtë, i mituri i pashoqëruar do të vendoset në strehim të mbrojtur. Këtu merren masa të mëtejshme sigurie, si për shembull më tepër siguri dhe mbikëqyrje. Përveç kësaj, policia (lokale) informohet për çdo rrezik shtesë. Në disa raste, një punonjës e di se një i mitur i pashoqëruar po planifikon të largohet nga qendra e strehimit. Në rast të tillë, stafi i qendrës së strehimit përpqet ta bindë fëmijën që të qëndrojë.

Nëse një fëmijë i pashoqëruar nis para kohe nga strehimi i mbrojtur, paralajmërohet menjëherë policia dhe NIDOS, dhe informohet Qendra Eksperte për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (EMM). Përveç kësaj, palët e përfshira takohen dhe vendosin për veprimet e mëtejshme që duhen provuar për të gjetur të miturin, duke u bazuar në informacionin e disponueshëm. Nëse policia e gjen të miturin, do ta kthejë te qendra e mbrojtur e strehimit. Nëse i mituri gjendet, kujdestari (NIDOS) do të përpilojë një raport në polici. Përveç këtyre masave shtesë, ekziston një analizë multidisiplinore e riskut për rrezikimin e të miturve në qendrën e mbrojtur të strehimit për të vlerësuar nevojat për mbrojtje shtesë, çfarë lloj ndjekjeje duhet dhe nëse i mituri ka nevojë apo jo për drejtim dhe mbrojtje të mëtejshme.

#### Në rastet ku fëmija ka shenja të trafikimit ose abuzimit<sup>71</sup>

Përfshihen autoritetet e mëposhtme dhe ato janë përgjegjëse për veprimet kryesore që janë shënuar me yllth (\*):

- ⇒ Autoriteti për azilin në **AT, BE, CY, DE\*, DK, FI, IE, NO, SE** dhe **SI**;
- ⇒ Autoritetet e pranimit **AT, BE, DK, FI, LT\*, NL, NO** dhe **SI**;
- ⇒ Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve **AT, DK, LT\*, NL** (NIDOS dhe EMM), **NO** dhe **SI**;
- ⇒ Autoritetet për mirëqenien sociale në **CY\*, DE\*, DK, EL, SE\*** nëse ka dyshime për keqtrajtim të fëmijës dhe **SI**;
- ⇒ Policia në **AT\*, BG\*, DK<sup>72</sup>, EL, FI\*, FR, HU, IE\*, NL\*, NO, PL\*, SE\*, SI** dhe **SK\***;

<sup>70</sup> Nuk jepet informacion specifik.

<sup>71</sup> Në shtetet anëtare të shënuara me yllth, autoritetet e përfshira e ndajnë përgjegjësinë për ndërmarrjen e hapave/veprimeve të para.

<sup>72</sup> Mund të kontaktohet gjithashtu Qendra Daneze kundër THB.

⇒ Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë në **AT\***, **DK** (Kryqi i Kuq Danez), **EL** (prokurori publik), **FR\*** (prokurori publik) dhe **SI** (përfaqësues ligjor, OJQ-të).

Direktivat specifike të EASO dhe UNHCR përdoren në **EE**, ndërsa në **ES**, ekzistojnë protokolle specifike që aplikohen në rastet e trafikimit ose abuzimit, si edhe në rastin e çdo forme tjetër dhune të pësuar.

B) TREGUES TË TRAFIKIMIT OSE ABUZIMIT						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë	Policia
AT	✓	✓	✓		✓*	✓*
BE	✓ Zyra për emigracionin	✓ Qendra e pranimit - dërgohet qendrës të specializuar të strehimit				
BG						✓* Komisioni Kombëtar për Luftimin e THB
CH	Bashkëpunimi me autoritetet kompetente (kantonale) (p.sh. autoritetet e prokurorisë, autoritetet kantonale për mbrojtjen e fëmijëve, OJQ-të, etj.)					
CY	✓ Identifikon çështjen			✓*		
DE	✓* Stafi special i trajnuar (Sonderbeauftragte)			✓ Shërbimi për mirëqenien e të rinjve *		
DK	✓ Shërbimi Danez për Emigracionin kontakton Qendrën Daneze kundër THB	✓	✓	✓	Kryqi i Kuq Danez	✓ Mund të kontaktohet gjithashtu Qendra Daneze kundër THB ✓* Qendra Daneze kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore kontaktohen nga Shërbimi për Emigracionin i Kryqit të Kuq Danez
EE <sup>73</sup>	Direktiva specifike					
EL				✓ Qendra Kombëtare për Solidaritetin Social	✓ Prokurori publik	✓ Departamenti kompetent i policisë

<sup>73</sup> Analizë rast pas rasti.

<sup>74</sup> Nuk jepet informacion specifik.



B) TREGUES TË TRAFIKIMIT OSE ABUZIMIT						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë	Policia
ES <sup>74</sup>	Zbatohet protokoll specifik. Procedura e azilit mund të pezullohet derisa të garantohet mirëqenia e të miturit në terma të përgjithshëm dhe në varësi të profilit të rrezikueshmërisë.					
FI	√ Kontakti me njësinë e pranimit	√				√* Sistemi kombëtar i asistencës për viktimat e trafikimit
FR					√* Prokurori publik	√ Policia, mjekësia ligjore
HU						√ ndihmë psikologjike
IE	√ IPO informon policinë					√* Policia
IT <sup>75</sup>						
LT		√*	√*			
LV <sup>76</sup>	Në të gjitha rastet, autoritetet e përfshira në procedurën e azilit duhet të veprojnë sipas ligjit. Deri tani nuk janë krijuar procedura specifike.					
NL	√ Vendos të miturit në qendër strehimi		√ NIDOS dhe EMM			√* Qendra Eksperte* për Trafikimin e Qenieve Njerëzore
NO	√ *	√ *	√ *			√ *
PL						√* Roja Kufitare/ Qendra Kombëtare e Konsultimit dhe Ndërhyrjes për viktimat e trafikimit
RO <sup>77</sup>						
SE	√ SMA i raporton policisë/shërbimeve sociale			√* Nëse ekzistojnë dyshime se fëmija është keqtrajtuar		√* Policia
SI	√	√	√	√	√ Përfaqësuesi ligjor, OJQ-të	√

<sup>75</sup> Nuk jepet informacion specifik.

<sup>76</sup> Autoritetet e përfshira në procedurën e azilit duhet të veprojnë në përputhje me ligjin. Nuk ekzistojnë procedura specifike.

<sup>77</sup> Nuk jepet informacion specifik.

B) TREGUES TË TRAFIKIMIT OSE ABUZIMIT						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë	Policia
SK						√* Policia

#### Shembuj nga praktika: referimi te autoritetet kompetente dhe ndihma

**HU:** Nëse mund të përcaktohet se aplikuesi fëmijë është trafikuar ose është abuzuar, ose ekziston një rast i dhunës që bazohet te gjinia, aplikuesi ka mundësinë të marrë ndihmë psikologjike. Zbatohen rregullat për aplikuesit me nevoja të veçanta. Situata e tyre merret parasysh gjatë procesit të azilit.

#### Në rastet ku ka një rast të ngutshëm të dhunës të bazuar në gjini, si për shembull martesë me forcë<sup>78</sup>

Autoritetet e mëposhtme janë përgjegjëse për të marrë masat e nevojshme për ta mbrojtur fëmijën, dhe ata që janë përgjegjës për të ndërmarrë veprimet kryesore janë shënuar me një yllth (\*):

- ⇒ autoriteti për azilin në **AT, BE, CY, DE\*, DK, FI, IE, NO, SE** dhe **SI**;
- ⇒ autoritetet e pranimit/akomodimit në **AT, BE, DK, FI\*, LT, NO** dhe **SI**;
- ⇒ autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve në **AT, BG\*, DK, LT NL\*, NO** dhe **SI**;
- ⇒ autoritetet për mirëqenien sociale në **CY\*, DE\*, DK, EL, SE** dhe **SI**;
- ⇒ policia në **AT\***(departamenti i hetimit kriminal), **DK, EL** (departamenti kompetent i policisë), **FI** (nëse ka shqetësime sigurie), **IE\*, NL, SE, SI** dhe **SK\***;
- ⇒ autoritetet gjyqësore (prokurori publik) në **AT\*, EL, FR\*, NL** dhe **NO**;
- ⇒ OJQ-të në **SI**.

C) RAST I NGUTSHËM I DHUNËS TË BAZUAR NË GJINI, SI PËR SHEMBULL MARTESA ME FORCË NË VENDIN TUAJ						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet/ e pranimit akomodimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë	Policia
AT	√	√	√		√* Prokurori publik	√* Departamenti i hetimit kriminal
BE	√	√ Qendra e pranimit - akomodim i veçantë nëse është nën 16 vjeç				
BG			√* Departamenti për mbrojtjen e fëmijëve			
CH	Bashkëpunimi me autoritetet kompetente (kantonale) (p.sh. autoritetet e prokurorisë, autoritetet kantonale për mbrojtjen e fëmijëve, OJQ-të, etj)					
CY	√ identifikon çështjen			√*		

<sup>78</sup> Në shtetet anëtare të shënuara me yllth, autoritetet e përfshira e ndajnë përgjegjësinë për ndërmarrjen e hapave/veprimeve të para.

C) RAST I NGUTSHËM I DHUNËS TË BAZUAR NË GJINI, SI PËR SHEMBULL MARTESA ME FORCË NË VENDIN TUAJ						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet/ e pranimit akomodimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë	Policia
DE	√* Stafi special i trajnuar (Sonderbeauftragte)			√* Shërbimi për mirëqenien e të rinjve		
DK	√	√ Nëse autoritetet komunale vendosin se fëmija ka nevojë për masa sociale, operatori i pranimit ose i qendrës së akomodimit vendos për masat	√	√		√
EE	Rastet procesohen rast pas rasti					
EL				√ Qendra Kombëtare për Solidaritetin Social	√ Prokurori publik	√ Departamenti kompetent i policisë
ES <sup>79</sup>	Zbatohet protokoll specifik. Procedura e azilit mund të pezullohet derisa të garantohej mirëqenia e të miturit në terma të përgjithshëm dhe në varësi të profilit të rrezikueshmërisë.					
FI	√ Kontakti me njësinë e pranimit	√*				√ Nëse ka shqetësime sigurie
FR					√* Prokurori publik	
HU						√ Merr ndihmë psikologjike <sup>80</sup>
IE	√ IPO informon policinë					√* Policia
IT <sup>81</sup>						
LT		√	√			
LV	Në të gjitha rastet, autoritetet e përfshira në procedurën e azilit duhet të veprojnë sipas ligjit. Deri tani nuk janë krijuar procedura specifike.					
NL			√* NIDOS		Prokurori publik	√
NO	√*	√*	√*		√*	

<sup>79</sup> Nuk jepet informacion specifik.

<sup>80</sup> Në **HU**, nëse mund të përcaktohet se aplikuesi fëmijë është trafikuar ose është abuzuar, ose ekziston një rast i dhunës që bazohet te gjinia, aplikuesi ka mundësinë të marrë ndihmë psikologjike. Zbatohen rregullat për aplikuesit me nevoja të veçanta. Situata e tyre merret parasysh gjatë procesit të azilit.

<sup>81</sup> Nuk jepet informacion specifik.

C) RAST I NGUTSHËM I DHUNËS TË BAZUAR NË GJINI, SI PËR SHEMBULL MARTESA ME FORCË NË VENDIN TUAJ						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet/ e pranimit akomodimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore dhe aktorët e tjerë	Policia
PL <sup>82</sup>						
RO <sup>83</sup>						
SE	√ SMA u raporton autoriteteve të tjera			√		√ Policia
SI	√	√	√	√	√ OJQ-të	√
SK						√* Policia

#### Shembuj nga praktika: raste të martesës me detyrim

Në **NL**, qeveria dëshiron t'i parandalojë martesat me detyrim. Ligji për martesat në **NL** kërkon që të dy partnerët të jenë të paktën 18 vjeç. Nëse dikush nën 18 vjeç martohet (ose është martuar) jashtë vendit, qeveria nuk e njeh martesën derisa të dy partnerët të kenë arritur moshën 18 vjeç. Kjo është përcaktuar në ligjin për martesat me detyrim (parandalimi). Në të gjitha rastet ku përfshihen martesat të fëmijëve, **NIDOS** do të bëjë një vlerësim dhe do të vendosë nëse një fëmijë mund të vendoset në qendrën e strehimit bashkë me partnerin. Është në dorë të kujdestarit të vendosë cilat janë interesat më të mira të fëmijës. Megjithatë, nën moshën 16 vjeç (dhe në rastet e martesës me detyrim), fëmijët nuk vendosen bashkë me partnerin.

#### Në rastet e aftësive të kufizuara, problemeve me shëndetin, shtatzëninë etj.<sup>84</sup>

Përfshihen autoritetet e mëposhtme dhe ato janë përgjegjëse për veprimet kryesore që janë shënuar me yllth.

- ⇒ Autoriteti për azilin në **CY, DE, DK, FI, IE, NO** dhe **SI**;
- ⇒ Autoritetet e pranimit/akomodimit në **AT, BE\*, DK, FI, LT, NO, PL** dhe **SI**;
- ⇒ Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve në **AT\*, DK, LT, NL** dhe **NO**;
- ⇒ Autoritetet për mirëqenien sociale **AT, BE\*, BG\*, CY\*, DE\*, DK, EL, FR, HU, SE\*, SI** dhe **SK\***;
- ⇒ Aktorët/autoritetet e tjera **BG** (autoritetet shëndetësore), **DK** (autoritetet shëndetësore), **IE\*** (policia) dhe **SI** (përfaqësuesi ligjor).

<sup>82</sup> Nuk jepet informacion specifik.

<sup>83</sup> Nuk jepet informacion specifik.

<sup>84</sup> Në shtetet anëtare të shënuara me yllth, autoritetet e përfshira e ndajnë përgjegjësinë për ndërmarrjen e hapave/veprimeve të para.

D) NË RASTIN E AFTËSIVE TË KUFIZUARA, PROBLEMEVE SHËNDETËSORE, SHTATZËNISË ETJ.						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore	Aktor/autoritetet tjetër
AT		√	√* Mirëqenia e të rinjve	√		
BE		√* Pranim i veçantë dhe i përshtatur		√* Sistemi shëndetësor belg në rastet e problemeve mjekësore tepër të rënda <sup>85</sup>		
BG				√* Autoritetet sociale dhe shëndetësore		√ Autoritetet shëndetësore/tjetër
CH	Bashkëpunimi me autoritetet kompetente (kantonale) (p.sh. autoritetet e prokurorisë, autoritetet kantonale për mbrojtjen e fëmijëve, OJQ-të, etj.					
CY	√ identifikon çështjen			√*		
DE	Merren parasysh sa më shumë të jetë e mundur nevojat e veçanta për intervistën			√*		
DK	√	√ Nëse autoritetet komunale vendosin se fëmija ka nevojë për masa sociale, operatori i qendrës së akomodimit vendos për masat	√	√		√ Autoritetet shëndetësore
EE	Rastet procesohen rast pas rasti					
EL				√ Qendra Kombëtare për Solidaritetin Social		
ES <sup>86</sup>	Zbatohet protokoll specifik. Procedura e azilit mund të pezullohet derisa të garantohet mirëqenia e të miturit në terma të përgjithshëm dhe në varësi të profilit të rrezikueshmërisë					
FI	√ Kontakti me njësinë e pranimimit	√				
FR				√ Kujdesi shëndetësor		
HU				√ Kujdesi shëndetësor		
IE	√ IPO informon policinë					√* Policia

<sup>85</sup> Përfshirje e fëmijëve të pashoqëruar.

<sup>86</sup> Nuk jepet informacion specifik.

D) NË RASTIN E AFTËSIVE TË KUFIZUARA, PROBLEMEVE SHËNDETËSORE, SHTATZËNISË ETJ.						
	Autoritetet për azilin	Autoritetet e pranimimit	Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve	Autoritetet për mirëqenien sociale	Autoritetet gjyqësore	Aktor/autoritetet tjetër
IT <sup>87</sup>						
LT		√	√			
LV	Në të gjitha rastet, autoritetet e përfshira në procedurën e azilit duhet të veprojnë sipas ligjit. Deri tani nuk janë krijuar procedura specifike.					
NL			√ NIDOS			
NO	√*	√*	√*			
PL		√ Qendrat e specializuara të kujdesit				
RO <sup>88</sup>						
SE				√* Shërbimet e kujdesit shëndetësor kontaktohen nga kujdestari		
SI	√	√		√	√ Përfaqësuesi ligjor	
SK				√* Shërbimet e kujdesit shëndetësor		

#### Shembuj të praktikës: rastet e aftësive të kufizuara, problemet shëndetësore, shtatzëni

**DK:** Në rastet e aftësive të kufizuara, problemeve shëndetësore, shtatzënisë, si edhe në rastet e dhunës të bazuar te gjinia, si për shembull martesë me detyrim, etj., merren masat e mëposhtme:

Azilkërkuesit e pashoqëruar dhe fëmijët emigrantë që bien nën mbikëqyrjen e DIS, si rregull i përgjithshëm strehohen në qendra të veçanta të azilit për fëmijë. Stafi i atyre qendrave stërvitet që të kujdeset për nevojat specifike të fëmijëve të rrezikuar.

Pas mbërritjes së një të mituri të pashoqëruar në **DK**, caktohet një përfaqësues personal për t'u shërbyer interesave më të mira të të miturit. Përfaqësuesi personal caktohet sa më herët të jetë e mundur në proces dhe para se të merret çfarëdo vendimi, dhe angazhohet me fëmijën gjatë të gjithë procesit. Caktimi mbaron kur fëmija bëhet 18 vjeç.

<sup>87</sup> Nuk jepet informacion specifik.

<sup>88</sup> Nuk jepet informacion specifik.

## Seksioni 5. Specializimi dhe trajnimi i stafit

Ky seksion tregon mjetet dhe trajnimet e ndryshme për të kualifikuar dhe specializuar stafin që është në kontakt me fëmijët ose që merret me dosjet e fëmijëve.

Shumica e shteteve (**AT, BE, CH, CY, DE, DK, EE, EL, FI, FR, HU, IE, IT, LV, NL, NO, SE, SI** dhe **SK**) kanë masa specifike për ekzaminimin e aplikimeve për mbrojtjen ndërkombëtare që kërkohet nga fëmijët. Mes tyre, 13 shtete të BE+ (**AT, BE, BG, CH, CY, DE, DK, EL, FI, FR, NL, NO** dhe **SE**) kanë funksionarë/njësi të specializuara, të cilët marrin trajnim përkatës specifik. Në **BG, ES, LT** dhe **PL** nuk ekzistojnë masa specifike për ekzaminimin e aplikimeve të fëmijëve. **RO** nuk ka dhënë informacion lidhur me këtë aspekt.

Në dhjetë shtete të BE+ (**BG, EE, ES, IT, IE, LT, LV, PL, RO** dhe **SI**), funksionarët e çështjeve që merren me aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitura nga fëmijët, trajnohen në mënyrë specifike, ndërsa në **HU, IE** dhe **SK** ka funksionarë të specializuar që merren me aplikimet e fëmijëve por nuk sigurohet trajnim.

Ekzistojnë masa të tjera:

- ⇒ masa specifike që do të ishin në BIC në **EE, EL** (premtime të caktuara, aty ku është e mundur), **FI**<sup>89</sup> dhe **SE**;
- ⇒ dhoma intervistimi të përshtatura në **BE, CY, DE, FR, IE, NL, IT, PL** dhe **SK**;
- ⇒ trajnim për përkthyesit në **BE, DE**<sup>90</sup>, **FR** dhe **IE**;
- ⇒ përkthyes të së njëjtës gjini në **CY, FR** dhe **SE**;
- ⇒ përfaqësues ligjor i trajnuar në **DK, FR** dhe **SE**;
- ⇒ merren masa specifike sipas nevojave të personit në **SI**;
- ⇒ sigurohen disa direktiva në **CH, EL, FR**;
- ⇒ psikolog i pranishëm në **PL, FR** (nëse fëmija ka probleme shëndetësore mendore).

### Shembull nga praktika: Specializim

Në **BE**, për shembull, ekziston një skuadër e specializuar e cila merret me aplikimet për azil të paraqitura nga fëmijët. Kjo skuadër ekspertësh merr trajnim të specializuar dhe direktiva në lidhje me trajtimin e aplikimeve për azil nga fëmijët dhe bëjnë takime rregullisht për tema specifike lidhur me fëmijët (qoftë të shoqëruar, qoftë të pashoqëruar). Masa të ngjashme ekzistojnë në **SK**, ndërsa në **SE**, ekzaminimi i aplikimit për azil përshtatet sipas moshës dhe pjekurisë së fëmijës, dhe bëhet në ambiente të përshtatura për fëmijë.

Në **DK**, funksionarët e çështjeve marrin parasysh moshën, pjekurinë, kombësinë dhe formimin e fëmijës kur shpjegojnë procedurën e azilit, dhe pyetjet e teknikave të intervistimit përshtaten për ta. Kjo shërben për t'u siguruar që fëmijët t'i kuptojnë procedurat për azilin dhe pyetjet.

Në **PL**, psikologë të specializuar japin ndihmë gjatë intervistave me fëmijët.

## Trajnimi

Funksionarët e çështjeve marrin trajnim specifik për trajtimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare që kërkohen nga fëmijët në 23 shtete të BE+ (**AT, BE, BG, CH, CY, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR** (ata që janë caktuar për të intervistuar fëmijë), **HU, IE, IT, LV, NL, NO, PL, RO, SE, SI** dhe **SK**). Në **LT**, nuk ofrohet trajnim për funksionarët e çështjeve.

Në 19 prej shteteve (**AT, BE, BG, CY, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IT, LV, NL, PL, RO, SE** dhe **SK**) përdoret një kombinim modulesh trajnimi, mjetesh dhe direktivash praktike të EASO. Mjetet e EASO përdoren në 18 prej shteteve (**AT, BG, CH, CY, DE, DK, EE, EL, ES, HU, IT, LT, LV, NO, PL, RO, SE** dhe **SI**). Direktivat praktike

<sup>89</sup> Funksionari i çështjes kërkon BIA nga punonjësi social

<sup>90</sup> Në formën e një videoje të veçantë.

të EASO ndiqen në 5 shtete të BE+ (**CY, EE, HU, LV, NO**) dhe modulet e trajnimit në 17 shtete anëtare (**AT, BE, BG, CH, CY, EL, FI, FR, HU, IT, LV, NL, PL, RO, SE, SI** dhe **SK**).

Në **BE**, është e detyrueshme të bëhet Trajnimi i EASO për intervistimin e fëmijëve. Një trajnim i mëtejshëm i specializuar 3-ditor në lidhje me fëmijët në procedurën e azilit, i cili përqendrohet te fazat e zhvillimit, trauma, ndjeshmëria kulturore, humbja, ndikimet e emigracionit të fëmijët dhe qëndrueshmëria janë gjithashtu pjesë e trajnimit të detyrueshëm kombëtar për funksionarët e çështjeve që merren me aplikimet e fëmijëve. Specializim i mëtejshëm për disa funksionarë të çështjeve të skuadrës për të miturit sigurohet nëpërmjet moduleve të EASO për IVP dhe SOGI. Në **CY**, Funksionarët me eksperiencë të çështjeve merren me aplikimet e fëmijëve për mbrojtje ndërkombëtare pasi kanë bërë disa sesione trajnimi, duke përfshirë modulet e EASO. Në mënyrë të ngjashme, në **EE**, funksionarët e çështjeve kanë kaluar modulën e EASO, si edhe trajnim të brendshëm të përshtatshëm.

Dhjetë prej shteteve ofrojnë trajnime kombëtare (**AT, BE, CH, DE, DK, FI, FR, NO, PL** dhe **SE**). Në **AT**, funksionarëve të çështjeve u ofrohet rregullisht nga ekspertët kombëtarë trajnim specifik për intervistimin e fëmijëve. Në mënyrë të ngjashme, **CH** dhe **DK**, ofrohet trajnim specifik lidhur me teknikën e intervistimit të fëmijëve dhe BIC. Në **DE**, ofrohet trajnim special bazë për ligjin dhe praktikën kombëtare, si edhe informacion për formimin psikologjik. Në **NO**, ofrohet trajnim kombëtar për teknikat e intervistimit, vlerësimin e moshës, vlerësimin e kredibilitetit, BIC dhe për kërkesa të tjera ligjore specifike për fëmijët. Në **SI**, funksionarët publikë bëjnë rregullisht trajnime sipas Ligjit për Mbrojtje Ndërkombëtare, dhe në mënyrë specifike, për trajtimin e të miturve dhe dhënien e ndihmës për ushtrimin e efektshëm të të drejtave të të miturve.

Përveç kësaj, në disa shtete (**CH, FR, IE – TUSLA**) përdorin direktivat e tyre kombëtare/të brendshme.

Raportet e vendit të origjinës (COI) përdoren në nëntë shtete të BE+ (**CH, DK, EE, EL, FR, IT, PL, SI** dhe **SK**) ndërsa direktivat e UNHCR ndiqen në nëntë shtete anëtare (**CY, DK, EE, FR, HU, IE, LV, RO** dhe **SK**).

## Specializimi për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët

Mundësia për të kërkuar këshilla, kur është e nevojshme, nga ekspertët për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, është e mundur në 21 prej shteteve (**AT, CH, CY, DE, DK, EE, EL, ES, FI, FR, HU, IE, IT, LT, LV, NO, PL, RO, SE, SI, SK**). Ekspertët mund të kërkojnë këshilla nga:

- ⇒ Ekspertët brenda njësisë/njësisë së specializuar: **CH, DE, FI, FR, HU, NO**
- ⇒ Institucionet e specializuara (Autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve/ prokurori publik): **EE, EL, ES, HU, IE, SI**
- ⇒ Ekspertë të tjerë (p.sh. mjekë, psikologë, avokatë): **DK, EE, IT** (në qendrat e pranimit), **LV, SK**
- ⇒ Këshilla të jashtme profesionale: **CY<sup>91</sup>, DE, SI**;
- ⇒ Specialistët operacionalë dhe ligjorë: **SE**

Ky opsion nuk është i disponueshëm në **BE** dhe **NL**.

**BG** nuk ka dhënë informacion specifik për mundësinë për të kërkuar këshilla nga ekspertët në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët.

<sup>91</sup> Në kuadrin e Planit të Ndhmës Speciale në Qipro të EASO, funksionarët e specializuar të çështjeve kanë mundësinë të diskutojnë për këto lloje çështjesh me ekspertët e EASO të vendosur në Qipro.



## Rekomandimet

Duke u bazuar në zbulimet e rëndësishme nga hartimi dhe të frymëzuar nga praktikat e mira të adoptuara nga autoritetet e shteteve dhe nga aksionarët e tjerë, EASO propozon rekomandimet e mëposhtme për t'iu përgjigjur sfidave dhe problemeve të identifikuara, në të cilat dobësohet mbrojtja e efektshme e fëmijëve në procedurat e azilit.

### Përkufizimet operacionale

Praktika tregon disa ndryshime të rëndësishme në figurat dhe rolet e analizuara në territorin e BE, i cili krijon një pabarazi në trajtimin e fëmijëve me raste të ngjashme.

► Ndërkohë që respektojnë veçantitë e sistemeve kombëtare, autoritetet duhet të nxitin konvergjen-cën në kategorizimin dhe trajtimin e fëmijëve, në mënyrë që të marrim të njëjtën mbrojtje pavarësisht nga situata ku ndodhen.

### Fëmijët e shoqëruar nga prindërit

Ekziston rreziku që nevojat për mbrojtje të fëmijëve të shoqëruar nga prindërit të anashkalojnë. Këto nevoja duhet të adresohen në mënyrë të pavarur, pavarësisht nëse fëmija është aplikues vetëm apo si person i varur nga prindërit në procedurën e azilit. Në disa raste, interesat e fëmijës dhe interesat e prindërve mund të kenë mospërputhje ose të bien ndesh me njëra-tjetrën. Në këto situata, është me shumë rëndësi të dëgjohen pikëpamjet e fëmijës. Jo vetëm sepse është një e drejtë që nxitet në CRC, por dhe një mundësi që funksionari i çështjes të **eksplorojë bazat e mundshme për mbrojtje ndërkombëtare** të cilat fëmija mund të mos jetë i gatshëm t'i tregojë në praninë e prindërve (p.sh. orientimi seksual ose pretendimet për identitetin gjinor).

► Sigurohu që fëmijët e shoqëruar të marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre dhe zëri i tyre të dëgjohet gjatë intervistave për azil.

Në këtë kuptim, sigurimi i informacionit të efektshëm dhe prania e masave mbrojtëse, si për shembull “konfidencialiteti” ose “mundësia e pasjes së një konsulenti ligjor” janë me rëndësi për fëmijën e shoqëruar. Autoriteti kombëtar për azilin, së bashku me aktorët e CP, duhet të vlerësojnë nëse fëmija duhet të intervistohet apo jo në praninë e konsulentit ligjor, krahasuar me praninë e prindërve. Këta aktorë duhet të vlerësojnë gjithashtu nëse prindërit duhet të kenë qasje te dosja e çështjes së fëmijës, në të cilën gjenden informacione konfidenciale, dhe nëse për fëmijën dhe prindërit duhet të jepen vendime veçmas lidhur me aplikimet e tyre për mbrojtje ndërkombëtare.

► Është me rëndësi të madhe që deklaratat e fëmijës të mos përdoren kundër fëmijës gjatë ekzaminimit të aplikimit të tyre për mbrojtje ndërkombëtare, ose gjatë ekzaminimit të aplikimit të prindërve. Fëmija duhet të informohet dhe të sigurohet për këtë gjatë intervistës.

Në përgjithësi, autoriteti kombëtar i azilit duhet të sigurojë që, çdo herë që përballet me një rast si ky, fëmija nuk do të vendoset në një situatë që mund t'i shkaktonte dëmtim atij dhe informacioni konfidencial nuk do t'u jepet prindërve pa aprovimin e fëmijës. Në çdo rast që vihen re shenja abuzimi dhe/ose shfrytëzimi, funksionari përgjegjës do të sigurohet që autoritetet përgjegjëse të informohen si duhet dhe që **fëmija të marrë ndihmë dhe kujdes**.

### Fëmijë të pashoqëruar

Fëmijët të cilët nuk janë të shoqëruar nga prindërit ose nga një i rritur përgjegjës për ta, ose të cilët gjenden në këtë situatë pasi hyjnë në territor, janë të pashoqëruar dhe duhet të konsiderohen e të trajtohen si të

tillë. Caktimi i një përfaqësuesi dhe/ose kujdestari duhet të jetë i menjëhershëm, në mënyrë që të mos zgjatë periudhën në të cilën fëmija gjendet në një situatë të tillë rreziku të pashmangshëm.

► Roli i përfaqësuesit në procedurën e azilit kërkon një person i cili e njih procedurën kombëtare të azilit dhe mund ta ndihmojë fëmijën që ta ndjekë atë.

Roli i përfaqësuesit, ose kujdestarit aty ku zbatohet, kërkon pavarësi, njohuri dhe përkushtim. Është e rëndësishme që ky rol të mos ketë konflikte interesi dhe të ushtrohet nga profesionistët, jo nga aplikues të tjerë për mbrojtje ndërkombëtare.

## Fëmijë të ndarë

Fëmijët që janë të shoqëruar nga të afërmit ose nga të rritur që nuk kanë lidhje me ta, janë fëmijë të pashoqëruar dhe atyre duhet t'u sigurohen masat mbrojtëse të nevojshme, si caktimi i një kujdestari ose përfaqësuesi njëlloj si çdo fëmijë tjetër të pashoqëruar. Fëmijët e ndarë mund të hasin rreziqe të caktuara kur janë në duart e të rriturit shoqëruar, sidomos kur i rrituri nuk është në gjendje të ofrojë kujdes të efektshëm për fëmijën ose mund të abuzojë me fëmijën. Për të parandaluar këtë, duhet të vlerësohet mirë marrëdhënia mes fëmijës dhe të rriturit.

Si pasojë, vëllezërit a motrat, bashkëshortët, pjesëtarët e familjes ose të afërmit e tjerë apo personat që e shoqërojnë fëmijën nuk duhet të konsiderohen përgjegjës për fëmijën. Për të gjetur një kujdestar të përshtatshëm, autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të bëjnë një vlerësim të plotë të kapacitetit dhe vullnetit të personit për t'u kujdesur për fëmijën.

► Sigurohu që të bëhet një vlerësim i kapacitetit dhe vullnetit të kujdestarit dhe që masat për kujdesin të jenë në interesat më të mira të fëmijës.

Është veçanërisht e rëndësishme të verifikohen lidhjet mes fëmijës dhe të rriturit për t'u siguruar që lidhja të jetë në interesat më të mira të fëmijës. Megjithatë, ky verifikim nuk duhet të kufizohet vetëm në lidhjet familjare të dokumentuara ose në lidhjet e gjakut (të afërmit ose kujdestarët jo kryesorë mund të mos kenë medoemos lidhje gjaku). Nga ana tjetër, nëse fëmijës nuk i lejohet të ketë kontakt me të rriturin shoqëruar, i cili mund të jetë personi i vetëm i besuar i fëmijës në situata zhvendosjeje, mund të jetë e dëmshme për fëmijën. Të gjithë elementët përkatës, duke përfshirë rreziqet e trafikimit dhe/ose shfrytëzimit, duhet të shqyrtohen me kujdes në dobi të interesave më të mira të fëmijës.

Procedimet përmes aplikimeve të veçanta për azil, mospjesëmarrja në intervistën e fëmijës ose moscaaktimi formalisht si kujdestar i fëmijës nuk nënkuptojnë ndarje fizike nga njësia familjare. Ndarja e familjes duhet të ndodhë vetëm kur kjo gjë është në interesat më të mira të fëmijës (në rastet ku ka tregues se fëmija është në rrezik).

## Fëmijë të martuar

Fëmijët e martuar duhet të konsiderohen dhe të trajtohen si fëmijë në të gjitha rastet.

Komiteti CRC<sup>92</sup> rekomandon që mosha minimale për martesë me dhe pa aprovim të caktohet në 18 vjeç, qoftë për vajzat, qoftë për djemtë. Përveç kësaj, Këshilli i Evropës u kërkon Shteteve Anëtare të “caktojnë ose ta ngrenë në 18 moshën statutore minimale të martesës për gratë dhe burrat”. Këshilli u kërkon më tej Shteteve Anëtare që të “mos njohin martesat me detyrim dhe martesat e fëmijëve që janë lidhur jashtë vendit, përveç rasteve ku njohja do të ishte në interesat më të mira të fëmijës për sa i përket efekteve të martesës, në veçanti për qëllimin e sigurimit të të drejtave, të cilat nuk do t'i merrnin dot ndryshe”.<sup>93</sup>

<sup>92</sup> Komiteti CRC, Koment i përgjithshëm nr. 6 (2005): Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve të ndarë jashtë vendit të origjinës, 1 shtator 2005, CRC/GC/2005/6, para. 23-24

<sup>93</sup> Këshilli i Evropës, Rezoluta Parlamentare 1468 (2005) për martesat me detyrim dhe martesat e fëmijëve, i disponueshëm në <http://assembly.coe.int/nw/xml/xref/xref-xml2html-en.asp?fileid=17380&lang=en>

Përkufizimi i *acquis* për azil në BE i një fëmije të pashoqëruar<sup>94</sup> nuk i përjashton fëmijët e martuar. Prandaj, fëmija i martuar duhet të konsiderohet i pashoqëruar dhe të përfitojë nga garancitë e veçanta procedurale që janë në dispozicion për fëmijët e pashoqëruar sipas APD (i ndryshuar), ose të shoqëruar nëse fëmija shoqërohet nga prindërit ose nga një i rritur përgjegjës (kujdestar ose përfaqësues).

► Në një situatë ku fëmija ndahet nga prindërit ose nga kujdestari ligjor, sigurohu që bashkëshorti nuk është caktuar si kujdestar i fëmijës.

Caktimi i bashkëshortit të fëmijës si kujdestar do të krijonte një situatë mungese ekuilibri, ku fëmija do të varej ligjërisht tek i rrituri, dhe kjo do ta vinte fëmijën në rrezik.

Kur shqyrtohen interesat më të mira të fëmijës së martuar gjatë procedurave të azilit, **duhet të shqyrtohet me kujdes marrëdhënia mes fëmijës dhe bashkëshortit**, për të përcaktuar qëllimin e martesës dhe nëse fëmija e ka dhënë apo jo aprovimin për t'u martuar.

Qëndrimi me një bashkëshort të rritur duhet të jetë mundësia e vetme nëse kjo është me dobi për fëmijën, pasi janë shqyrtuar arsyet për vartësinë. Është e rëndësishme të shqyrtohet nëse çifti ka fëmijë, dhe nëse po, të drejtën e unitetit familjar. Në Shtetet Anëtare, ku mosha e aprovimit përcaktohet nga kombësia e bashkëshortëve, por jo nga vetë Shtetet Anëtare, duhet të ekzistojnë disa masa mbrojtëse.

Pasi të përcaktohet se lidhja është konsensuale dhe është në interesat më të mira të fëmijës, dhe vetëm në situatë të tillë, mund të merret në shqyrtim nëse fëmija dhe bashkëshorti duhet të vlerësohen në të njëjtin aplikim dhe se si kjo mund të ndikojë te masat për pranimin e tyre. Është e nevojshme mbyllja e përfshirjes së autoriteteve përkatëse të Shteteve Anëtare për të siguruar mbrojtjen e fëmijës gjatë procedurës.

## Fëmijët që kanë fëmijët e tyre

Është e rëndësishme të shqyrtohet nëse çifti ka fëmijë, dhe nëse po, nëse ka të drejtën e unitetit familjar, dhe nëse mund të ketë shqetësime të mëtejshme për mbrojtje të fëmijëve të tyre. Interesat më të mira të fëmijëve të vetë fëmijës duhet të vlerësohen gjithashtu veçmas.

► Sigurohu që të bëhet një vlerësim i interesave më të mira për çdo fëmijë.

## Fëmijët që janë në rrezik ose që janë viktimat të trafikimit

Çdo rrezik i mundshëm trafikimi duhet të shqyrtohet me kujdes, si për shembull për sa i përket kushteve të pranimit dhe këshillimit.

► Sigurohu që të ekzistojnë të gjitha masat mbrojtëse dhe që viktimat fëmijë ose viktimat e mundshme të THB, si edhe të dashurit e tyre, të jenë të mbrojtur. Këto masa mbrojtëse përfshijnë aplikimin e mekanizmi kombëtar i referimit për të siguruar ndihmë të përshtatshme.

Merr parasysh nëse është në interesat më të mira të fëmijës që të vazhdohet me procedura të caktuara për viktimat e trafikimit ose me procedurën e azilit, ose nëse fëmija duhet të vazhdojë njëkohësisht të dyja procedurat, në varësi të praktikës kombëtare të shtetit të BE+ në fjalë.

## Fëmijët e humbur

Zhdukja e fëmijëve nga kanalet dhe procedurat zyrtare është një nga problemet më shqetësuese për autoritetet dhe palët e tjera.

Gjatë lëvizjes, para dhe pas hyrjes në BE, fëmijët që nuk vihen re gjatë rrugës së emigrimit për në BE përballen me rrezikun për t'u bërë pre e lehtë e rrjeteve të trafikimit. Shpesh, transportuesit e rrjeteve të trafikimit

<sup>94</sup> Pika 2(l) QD (ndryshim).

paraqiten si trafikantë të zakonshëm për të mundësuar transferimin e fëmijës në rrjetet e trafikimit. Përveç kësaj, trafikantët mund të përfitojnë nga mungesa e mbrojtjes së një fëmije për të abuzuar me të.

► Sigurohu që të vlerësohet nëse ekziston rreziku që fëmija të zhduket/të humbë nga qendra e strehimit për ndonjë arsye, duke përfshirë përpjekjen për të kaluar në një shtet tjetër të BE+, dhe të merren masa për të pakësuar këtë rrezik.

Rreziku mund të pakësohet duke e informuar si duhet fëmijën për procedurat e azilit dhe afatet që priten; duke i dhënë rregullisht fëmijës informacione të qarta, të kuptueshme dhe të përshtatshme për moshën që ka, në mënyrë specifike për pasojat dhe rreziqet që vijnë nëse përpriqet të shkojnë në mënyrë të parregullt në një shtet tjetër të BE+, qoftë vetëm, qoftë me ndihmën e rrjeteve kriminale ose trafikantëve. Prioritizimi i çështjes është një mënyrë tjetër për të pakësuar këtë rrezik.

## Fëmijët LGBTI

Fëmijët kanë gjithashtu pretendime të bazuara në orientimin seksual, identitetin dhe shprehinë e tyre gjinor. Zbulimi në kohë mbetet një sfidë, pasi shpesh fëmija vjen nga një vend ku të jesh një person LGBTI është tabu, e madje krim. Sigurimi i informacionit është i rëndësishëm për ta vënë fëmijën në dijeni për mbrojtjen në vendin mikpritës.

Gjithashtu është e rëndësishme që të ketë një përkthyes të specializuar, i cili ka bërë trajnim për termat neutralë dhe të thjeshtë që përdoren në gjuhën e përkthimit, dhe prandaj duhet të zgjedhë ato terma të cilat nuk kanë ngjyrimë përçmuese. Përkthyesi dhe intervistuesi duhet të pranojë dhe të pasqyrojë termat që përdor fëmija për të përshkruar veten (përveç nëse termat janë përçmuese) dhe t'i referohet rrethanave të tyre për COI përkatëse dhe jo perceptimeve Eurocentrike.

Përveç kësaj, ka shumë mundësi që fëmija të ketë mendime negative se është i përjashtuar nga shoqëria, ka vuajtur nga stigma, izolimi dhe ndjenjat e turpmit.

► Sigurohu që mënyra e vlerësimit të këtyre faktorëve të bëhet me anë të përshkrimit të këtyre ndjenjave dhe duke të shpjeguar mënyrën se si mendojnë.

Analiza e pretendimit nuk duhet të bazohet te manerizmat ose te hamendësitë subjektive (çfarë pamje ka një fëmijë homoseksual, ose si duhet të sillet, etj.); pasojat e paragjykimeve. Funkcionari i çështjes nuk duhet të bëjë asnjëherë pyetje personale për praktikat seksuale të aplikuesit dhe as nuk duhet të shohin, as të pranojnë materiale me natyrë seksuale.

## Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara mund të kenë më tepër vështirësi të kuptojnë informacionin që u jepet dhe mund të kenë vështirësi për të dhënë prova për aplikimin e tyre. Prandaj, funksionari i çështjes dhe personat që janë në kontakt me fëmijën duhet të kenë barrën më të madhe të provës dhe të jenë dyshues deri në shkallën më të lartë. Si pasojë, është e domosdoshme pasja e një qëndrimi proaktiv dhe empatik për sa i përket vlerësimit të nevojave të veçanta, dhe duhet të bëhet një referim për ndihmë sipas nevojës, për shembull për kujdes mjekësor ose psikologjik ose ndihmë materiale, qoftë edhe në fazën e pranimit.

► Sigurohu që të vihen në dispozicion ndihma e nevojshme (intervistues dhe përkthyes i specializuar, kanale të përshtatura për sigurimin e informacionit dhe ambientet).

Nuk duhet të përfshihen konkluzione lidhur me diagnozën shëndetësore të fëmijës ose të aplikuesve shoqëruar, përveç nëse është bashkëngjitur një raport mjekësor.

## Fëmijët me trauma ose shqetësime psikologjike

Eksperiencat në vendin e tyre (si lufta, vdekjet e pjesëtarëve të familjes ose abuzimi seksual), gjatë udhëtimit (për shembull ekspozimi ndaj dhunës ose diskriminimit) në vendin mikpritës (racizmi, pasiguria lidhur me statusin e tyre ligjor në të ardhmen) mund të jetë diçka traumatike. Edhe pse fëmijët janë shumë të qëndrueshëm, ekziston rreziku i lartë që fëmijët të shfaqin probleme të shëndetit mendor si pasojë e këtyre eksperiencave të hidhura.

Mënyra në të cilën fëmija reagon ndaj situatave stresuese varet nga mosha dhe faza e tyre e zhvillimit. Si pasojë e përjetimit të një humbjeje, zhvillimi i fëmijës mund të përkeqësohet në nivelin konjitiv dhe emocional. Fëmijët mund të kenë vështirësi të shprehin e emocionet e tyre, të shprehin hidhërim ose t'i shprehin emocionet në mënyrë shpërthyes. Ata mund të vuajnë nga probleme të tjera të zakonshme të shëndetit mendor për shkak të çrënjësjes, si depresion, ankth, pikëllim, shqetësime në gjumë, si edhe agresion, prirje për vetëvrasje dhe psikozë.

Trauma ose shqetësimi psikologjik mund të ndikojë te aftësia e një fëmije për të dëshmuar për eksperiencat e tij, dhe prandaj këto dobësi duhet të merren parasysh gjatë intervistës personale. Për t'i ndihmuar fëmijët të tregojnë eksperiencat e tyre, është i domosdoshëm qëndrimi **empatik** i intervistuesit.

► Sigurohu që stafi të jetë i trajnuar për teknikat e intervistimit të përshtatshme për fëmijë për të parandaluar traumat dhe shqetësimet e mëtejshme.

Përveç kësaj, funksionari i çështjes që merret me rastin e fëmijës duhet të kërkojë informacion në mënyrë **proaktive** nga aktorë të tjerë për të plotësuar informacionin e marrë.

Në rastin e mendimeve të fragmentuara dhe të shkëputura, funksionari duhet të marrë përsipër një **barrë më të madhe prove**. Në rastet ku informacioni i marrë gjatë intervistës personale nuk është përsëri i mjaftueshëm, zbatohet **dobia e dyshimit**. Në rastin ku fëmija duhet tepër i traumatizuar ose nuk është në gjendje të shprehet, intervista mund të jetë në dëm të fëmijës ose mund të pengojë rikuperimin e tij. Në ato raste, intervista nuk duhet të bëhet ose duhet të shtyhet derisa fëmija të jetë në gjendje.

## Rrezikshmëritë e shumta

Rekomandimet e mësipërme kanë për qëllim rreziqet specifike dhe rreziqet shtesë (fëmijët që janë viktimat të TBH, fëmijët me aftësi të kufizuara), megjithatë mund të ketë raste me rreziqe më pak të dukshme por që janë po kaq të rëndësishme (fëmijët që janë viktimat të torturës ose të formave të tjera të dhunës fizike dhe psikologjike, duke përfshirë dhunën e bazuar te gjinia, etj.) të cilat nuk janë identifikuar. Prandaj është shumë e rëndësishme që funksionari të jetë tepër i kujdesshëm ndaj çdo treguesi shtesë për nevoja të veçanta dhe ndaj treguesve për rreziqe të tjera më pak të dallueshme, në veçanti ato që vijnë nga arsyet për persekutim që janë specifike për fëmijët (për shembull, një vajzë me probleme të rënda shëndetësore ka qenë objekt i FGM).

Disa rreziqe të caktuara mund të dëmtojnë aftësinë e fëmijës për të kuptuar procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare dhe për të paraqitur dhe vërtetuar pretendimet e tij gjatë intervistës personale.

► Është detyra e çdo funksionari që të dallojë rreziqet shtesë në çfarëdo faze dhe të bëjë rregullimet e nevojshme gjatë fazave të ndryshme të procedurës për t'u siguruar që të plotësohen nevojat e veçanta të fëmijës.

## Interesat më të mira të fëmijës

BIC është dika me shumë rëndësi që duhet ekuilibruar me interesat e të tjerëve, duke përfshirë ato të shtetit. Pësha që duhet t'i jepet BIC do të jetë pjesë e analizës së vendimmarrjes. Do të ketë prioritet të lartë dhe nuk do të jetë thjesht një prej konsideratave të tjera<sup>95</sup>.

T'i japësh konsideratë kryesore BIC është një proces i vazhdueshëm që kërkon një vlerësim para se të merret çfarëdo vendimi i rëndësishëm administrativ. Proceset BIC duhet të fillojë para procedurës së azilit dhe të vazhdojnë pas saj. Ndërkohë që fëmija është në procedurën e azilit, vlerësimi i BIC mbetet një detyrim për mbrojtjen e fëmijës, për autoritetet e azilit dhe për aktorët e tjerë. Aktorët për mbrojtjen e fëmijëve do të kryejnë njëkohësisht BIA për qëllime të shumta (pranim, edukim, kujdestari, etj.). Në të njëjtën kohë, autoritetet për azilin janë gjithashtu përgjegjëse për t'i dhënë konsideratë kryesore BIC në të gjitha fazat e procedurës së azilit. Këto vlerësime duhet të ushqejnë njëra-tjetrën, në mënyrë që të gjitha proceset të nxjerrin dobi nga sinergjitë e nevojshme dhe të shmangin mbivendosjen te njëra-tjetra.

► Kur autoritetet për azilin janë të parat që bien në kontakt me fëmijën, ose janë të ngarkuara me rrugë të ndryshme procedurale/ligjore, ato duhet të thirren për të nisur proceset BIC.

Në këto raste, dhe sidomos aty ku ato përfshijnë pyetje në lidhje me BIC dhe garanci procedurale në intervistën personale, ato duhet të përfshijnë të gjithë aktorët përkatës dhe të mos i mohojnë fëmijës mundësitë që të dëgjohet veçmas për çështjen e BIC të tyre.

Duhet të merren parasysh interesat më të mira të fëmijës para se të merret çfarëdo vendimi që ndikon te fëmija. Këto vendime duhet të përfshijnë faktin nëse aplikimi i fëmijës duhet të ndahet nga ai i prindërve, i bashkëshortit ose i pjesëtarëve të tjerë të familjes, ose nëse duhet të bëhet një intervistë personale më vete me fëmijën pa praninë e prindërve. Disa vendime të tjera mund të jenë fakti nëse intervistimi është në interesat më të mira të fëmijës, në cilin vend, kur dhe sa kohë duhet të zgjatë intervista; zgjedhja e një përkthyesi/funksionari çështjeje/funksionari regjistrimi që merret me aplikimin e fëmijës; vendosja për të bërë një vlerësim për moshën<sup>96</sup> ose gjurmimi i familjes së fëmijës; dhe ku të caktohet fëmija, etj.

Konsiderohet praktikë e mirë të siguroheni që çdo rekomandim ose vlerësim i bërë në lidhje me interesat më të mira të fëmijës të rishikohet dhe të aprovohet, duke përdorur parimin e katër syve ku të paktën dy funksionarë e shqyrtojnë çështjen.

Kur vlerësohet BIC, nëse fëmija dëshiron dhe nëse është e mundur, intervistat BIA me fëmijën duhet të bëhen nga një vlerësues dhe përkthyes zyrtar, i cili ka gjininë që preferon fëmija.

Vlerësuesit duhet që me nismën e tyre të marrin informacione nga burime të rëndësishme për qëllimet e vlerësimit, sidomos prej burimeve që kanë dijeni për situatën e fëmijës (si kujdestari/përfaqësuesi, personi që kujdeset për fëmijën, punonjësit socialë në qendrat e pritjes, pjesëtarë të familjes, etj.). Prandaj, detajet e kontaktit të palëve përkatëse duhet të merren siç kërkohet para BIA.

Çdo proces vendimmarrjeje në të cilën BIC është me rëndësi parësore, duhet të përfshijë respektin për të drejtat e fëmijës që të shprehë lirshëm mendimin e tij. Në rastet ku fëmija dëshiron të dëgjohet, ai mund të vendosë si (me shkrim, me vizatim, me gojë), dhe nëse dëshiron direkt apo nëpërmjet një përfaqësuesi (kujdestar/prind). Nëse fëmija e ka shprehur mendimin e tij, qoftë direkt, qoftë indirekt, duhet t'i jepet rëndësia e duhur pikëpamjeve të dhëna në përpunime me moshën dhe pjekurinë.

Kur fëmija e kupton se mendimet e tij merren parasysh, ai mund të jetë më i gatshëm të bashkëpunojë, e cila është në dobi të procedurës. Marrja parasysh e mendimeve të fëmijës nuk do të thotë që të gjitha

<sup>95</sup> Komiteti CRC, *Komenti i përgjithshëm nr. 14 (2013) për të drejtat e fëmijës që interesave të tij më të mira t'u jepet konsiderata më e lartë (pika 3, para. 1)*, 29 maj 2013, CRC/C/GC/14, Seksioni IV.A.4, para. 36-40.

<sup>96</sup> Vlerësimi i moshës është procesi me të cilin autoritetet përpunojnë moshën kronologjike ose grupmoshën e një personi, për të përcaktuar nëse personi është fëmijë apo i rritur. Informacioni më i mirë gjendet në EASO, *Udhëzues praktik për vlerësimin e moshës*, 2018.

dëshirat e tij mund të realizohen, por kur është e mundur, ato do të ndikojnë te procesi, ndërkohë që vendimi përfundimtar do të varet nga rrethanat e rastit.

## Procedura e azilit

Këto garanci procedurale dhe masa mbrojtëse duhet të sigurohen gjithnjë dhe të aplikohen si pjesë e procedurës së azilit për fëmijët. Garancitë procedurale janë detyrime për autoritetet dhe të drejtat e fëmijëve.

### *Aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare:*

Shumë prej masave mbrojtëse që janë specifike për procedurën e azilit mund të aplikohen tashmë në bërjen e aplikimit, dhe nga ky moment fëmija konsiderohet aplikues.

### *Vlerësim i moshës*

Kur moshë nuk dihet ose ka dyshime të bazuara për moshën, autoritetet mund të kenë nevojë të vlerësojnë moshën e personit për të përcaktuar nëse është madhor apo i mitur. Në aplikimin e dobisë së dyshimit, aplikuesi duhet të konsiderohet dhe të trajtohet si fëmijë derisa të zbulohet se është person i rritur.

Procesi i vlerësimit të moshës<sup>97</sup> duhet të kryhet sipas një qasjeje globale dhe shumëdisiplinore, e cila duhet të sigurojë ekzistencën të gjitha garancive dhe parimeve të nevojshme të parashikuara dhe mbrojtjen e të drejtave të azilkërkuarit. Meqenëse aktualisht nuk ekziston një metodë e vetme për të përcaktuar moshën e saktë të njeriut, grupmosha e personit në fjalë mund të ngushtohet duke përdorur një kombinim metodash që vlerësojnë jo vetëm zhvillimin fizik, por edhe pjekurinë dhe zhvillimin psikologjik.

► Për qëllimet e vlerësimit të moshës nuk duhet përdorur asnjë metodë ku përfshihen zhveshja lakuriq apo ekzaminimi, këqyrja ose matja e organeve gjinitale apo pjesëve intime.

Pasi aplikuesi fëmijë zbulohet se nuk është i shoqëruar nga prindërit ose nga ndonjë person i rritur përgjegjës, duhet të caktohet menjëherë një kujdestar/përfaqësues dhe fëmija duhet të informohet menjëherë për procesin e gjurmimit të familjes. Informimi dhe njohja e procesit dhe e qëllimit të tij do ta ndihmonte më tej fëmijën që të jepte informacionin e nevojshëm për të nisur gjurmimin e familjes.

### *Gjurmimi i familjes*

Qëllimi i gjurmimit të familjes është të gjendet informacion se ku ndodhen pjesëtarët e familjes ose ish-kujdestarët e fëmijës së pashoqëruar.

Informacioni i mbledhur mund t'u japë mundësi palëve përkatëse të dallojnë nevojat e veçanta të fëmijës dhe në varësi të këtyre nevojave, të përgatitin dhe të sigurojnë mbrojtje dhe kujdes të përshtatshëm e të personalizuar, si edhe të përcaktojnë cilat janë interesat më të mira të fëmijës duke u bazuar në rrethanat individuale të tij.

Pasi të konfirmohet se gjurmimi është në interesat më të mira të fëmijës, duhet të nisët procesi i gjurmimit të familjes pa asnjë vonesë dhe t'i jepet prioritet duke respektuar ndërkohë masat mbrojtëse procedurale. Megjithatë, këshillohet një periudhë reflektimi dhe pushimi për fëmijën.

► Në rastin e gjurmimit të suksesshëm të familjes, dhe me kusht që të jetë në interesat më të mira të fëmijës, kjo mund të çojë në rivendosjen e marrëdhënieve familjare. Së fundi, mund të çojë në ribashkimin e fëmijës me familjen për qëllimet e vlerësimit.

<sup>97</sup> Udhëzime të mëtejshme mund të gjenden në EASO, [Udhëzues praktik për vlerësimin e moshës](#), 2018.

Pasi gjendet fëmija ose nëse fëmija duket se është i shoqëruar nga të rritur që pretendojnë se janë pjesëtarë të familjes ose të afërm, autoritetet duhet të verifikojnë ekzistencën e lidhjeve familjare mes fëmijës dhe pjesëtarit të supozuar të familjes. Duhet të vlerësohet kapaciteti dhe vullneti i pjesëtarit të familjes për t'u kujdesur për fëmijën dhe për të vepruar në interesat më të mira të tij.

## Prioritizimi

Procedurat e azilit për fëmijët duhet të trajtohen me prioritet të lartë. Prioritizim do të thotë të veprosh në fillim, jo të veprosh shpejt.

► Prioritizimi i një dosjeje nënkupton marrjen sa më parë të vendimeve në lidhje me një dosje.

Kjo pajtohet me vënien e procedurës në pritje, në rastet ku kjo do të ishte shumë e përshtatshme duke marrë parasysh rrethanat (fëmija është në rrezik ose është viktimë e TBH, fëmija ka nevojë për terapi që të hapet, mungon përfaqësimi ose përkthimi, etj.). Kjo është e përshtatshme me kusht që vlerësimi dhe vendimi për të pezulluar procedurën të bëhen në mënyrë të shpejtë. Nëse është kështu, fëmija dhe kujdestari duhet të informohen menjëherë për kohëzgjatjen dhe arsyet e pezullimit. Duhet siguruar që fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të mos lihen në pritje pa pasur rrethana që e justifikojnë me patjetër këtë vendim. Vendimi për të pezulluar procedurën duhet të vlerësohet rregullisht.

## Vlerësimi i rrezikshmërisë dhe identifikimi i nevojave të veçanta

Identifikimi i nevojave të veçanta procedurale të fëmijëve është gjithashtu detyrim sipas APD (i ndryshuar), si edhe bërja e vlerësimeve për rrezikshmërinë - sipas Direktivës për Kushtet e Pranimit (i ndryshuar). Kjo mund të kërkojë përfshirjen e të gjithë aktorëve, si për shembull aktorët për mbrojtjen e fëmijëve ose ofruesit e shërbimeve.

► BIA-të e vazhdueshme duhet të marrin parasysh faktin se kapacitetet ose nevojat e veçanta të fëmijës evoluojnë me kalimin e kohës dhe masat e marra mund të rishikohen ose të përshtaten sipas rrethanave, krahasuar me marrjen e vendimeve definitive dhe të pakthyeshme.

Gjatë procedurave të azilit, fëmijët duhet të mbrohen nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, pakujdesisë dhe shfrytëzimit. Funkionarët e azilit duhet të marrin parasysh dhe të jenë vigjilentë ndaj treguesve të mundshëm të rrezikshmërisë dhe rreziqeve, si arratisja, për të garantuar sigurinë e fëmijës gjatë procedurave të azilit. Këtu mund të përfshihen, ndër të tjera, pyetje në lidhje me eksperiencat e fëmijës në shtëpi, gjatë udhëtimit ose në kamp, aspektet shëndetësore, dhe marrëdhënia me familjen shoqëruese dhe/ose kujdestarin shoqërues.

Duhet të merret informacion për mirëqenien e fëmijës, dhe çdo merak për mbrojtjen ose sigurinë. Marrja e këtij informacioni dhe dhënia e rëndësisë së duhur atij mund t'i ndihmojë për të garantuar mbrojtjen e fëmijës, për shembull për të mos lejuar që fëmija të bjerë në duart e personave që e kanë abuzuar, dëmtuar ose trafikuar fëmijën apo të lidhë përsëri kontakt me ta.

Çështjet e referuara në këto rekomandime mund të ndikojnë te kushtet e pranimit dhe te standardet e pranimit/akomodimit<sup>98</sup>.

## Përfaqësimi

Sipas FRA<sup>99</sup>, përdorimi i termave kujdestar, përfaqësues dhe përfaqësues ligjor nuk është i njëjtë në të gjithë BE, dhe terminologjitë kombëtare ndryshojnë. Prandaj, referenca për të identifikuar këto figura duhet të jetë te funksionet e personit të caktuar më tepër sesa te emërtimi. Roli i përfaqësuesit në procedurën

<sup>98</sup> Shiko EASO, Udhëzues për kushtet e pranimit për fëmijët e pashoqëruar: standardet dhe treguesit operacionalë, dhjetor 2018.

<sup>99</sup> Shiko FRA, Raport për sistemet e kujdestarisë për fëmijët që u është mohuar kujdesi prindëror në Bashkimin Evropian, tetor 2015.



e azilit, siç parashikohet në *acquis* të azilit në BE, kërkon një person i cili e njeh procedurën kombëtare të azilit dhe mund ta ndihmojë fëmijën që ta ndjekë atë. Detyrat e rëndësishme në procedurën e azilit (si sigurimi i informacionit të besueshëm për fëmijën, përgatitja e fëmijës për intervistën personale, dhënia e aprovimit në emër të fëmijës, identifikimi i nevojave të veçanta të fëmijës dhe veprimi në interesat më të mira të fëmijës) i besohen kujdestarit/përfaqësuesit.

► Duke pasur parasysh këto detyrime, autoritetet duhet të sigurohen që personat që janë caktuar, të mos kenë konflikte interesi dhe që të jenë në gjendje ta përmbushin si duhet këtë rol në mënyrë të pavarur, eksperte dhe me përkushtim.

Si pasojë, profesionistët (në kuptimin e gjerë, duke përfshirë vullnetarët ose stafi që ka marrë trajnimin e përshtatshëm) janë më të përshtatshmit për të përmbushur këtë rol, krahasuar me aplikuesit e tjerë për mbrojtje ndërkombëtare, të cilët përballen me pasiguri për statusin ligjor të tyre.

Për t'i dhënë mundësi kujdestarit/përfaqësuesit që të kryejë disa prej këtyre detyrave, ata duhet të informohen plotësisht për procedurat dhe të japin aprovimin në rastet ku ato janë në përputhje me interesat më të mira të fëmijës. Ai duhet të jetë i pranishëm në çdo intervistë që bëhet me fëmijën, pasi prania e kujdestarit është pjesë e garancisë se të drejtat e fëmijës po respektohen gjatë intervistës. Megjithatë, në rastet e fëmijëve me prindër ose fëmijë të ndarë, ku kujdestari/përfaqësuesi është një aplikues tjetër, ata mund të kenë vështirësitë e tyre për të kuptuar sistemin ose mund të kufizojnë ose mund të ndikojnë në narracionin e fëmijës, interesat më të mira të fëmijës mund të jenë që ai të mos jetë i pranishëm gjatë intervistës.

## Sigurimi i informacionit

Për të shmangur pengesat gjuhësore dhe problemet me komunikimin, informacioni duhet të jepet në një gjuhë që fëmija e kupton. Për të shmangur mbingarkimin e fëmijëve me informacion të tepërt gjatë pranimit, sigurimi i informacionit mund të bëhet në kohë ose faza të caktuara, në përputhje me nevojat individuale të fëmijës dhe në përputhje me kapacitetin e tij. Duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse për t'u siguruar që fëmija të shprehë pikëpamjet, dëshirat dhe mendime të tij, dhe të bëjë pyetje e të marrë vendime të informuara për të marrë pjesë në proces.

Kujdestari ka rolin e rëndësishëm për t'u siguruar që fëmija të informohet siç duhet dhe t'i kuptojë procedurat dhe rezultatet e mundshme të këtyre procedurave.

► Fëmijët duhet të informohen për procedurat e azilit dhe duhet të shihet sa është kuptueshmëria e tyre, si për shembull sa i kuptojnë pasojat për jetën e tyre.

## Intervista e përshtatshme për fëmijë<sup>100</sup>

Duhet të merren parasysh interesat më të mira të fëmijës kur merret vendimi nëse duhet intervistuar dhe si të intervistohet fëmija gjatë procedurës së azilit. Në vlerësimin individual duhet të merret parasysh jo vetëm kapaciteti i fëmijës për të pasur mendimin e tij dhe aftësinë e tij për të komunikuar (p.sh. në rastet ku kjo gjë nuk është praktike për shkak të aftësive të kufizuara, etj.), por edhe rikuperimi i tyre nga përvojat traumatike dhe ndikimi që ka shëndeti i tyre mendor tek intervista. Vlerësimi individual duhet të marrë parasysh gjithashtu disponueshmërinë e informacionit të marrë nga intervistat e mëparshme dhe burimet e tjera. Mund të mos jetë e nevojshme që të bëhet intervistë personale me ta për mbrojtje personale nëse përgjegjësia e prindërve të tyre siguron në mënyrë të mjaftueshme statusin e tyre dhe nuk janë gjetur tregues për baza të tjera individuale.

► Pasi intervista personale konsiderohet me dobi për fëmijën, ajo duhet të përshtatet sipas nevojave të veçanta të tij.

<sup>100</sup> Për trajnim të mëtejshëm se si të bëhet një intervistë personale me fëmijët, mund të regjistroheni për Modulin mësimor trajnues të EASO për intervistimin e fëmijëve.

Rekomandohet që gjatësia e intervistës dhe pushimet të përshtaten sipas vëmendjes së fëmijës dhe që funksionari përgjegjës dhe përkthyesi të jenë sa më joformalë dhe empatikë që të jetë e mundur. Nëse është e mundur, fëmija duhet të pyetet nëse ka ndonjë preferencë për sa i përket gjinisë së funksionarit/funksionares dhe përkthyesit/përkthyeses. Në varësi të formimit të fëmijës, mund të ndodhë që të zgjedhë dikë të seksit tjetër, p.sh. një djalë i cili i ka mbijetuar abuzimit seksual nga një burrë, mund të dëshirojë që të jenë të pranishëm një funksionare dhe një përkthyesë femër.

Informacioni duhet të jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë. Duhet kuptuar nevojat, pasi disa fëmijë mund të mos guxojnë të bëjnë pyetje për shkak të moshës, formimit kulturor ose gjendjes psikologjike. Kur bëhen intervista personale me aplikuesit fëmijë, është jetësore që intervistuesi të marrë informacion për gjendjen e përgjithshme të fëmijëve në vendin e origjinës. Pozita e fëmijëve në shoqëri mund të jetë e ndryshme në varësi të rajonit ose vendit të origjinës së fëmijës. Në disa kultura, pozicioni social i një personi rritet në bazë të moshës dhe fëmijëve u jepen shumë pak të drejta ose mbrojtje ligjore.

## E drejta e fjalës

E drejta e fjalës zbatohet për të gjithë fëmijët që janë në gjendje të kenë mendimin e tyre, pavarësisht moshës që kanë. Dëgjimi i mendimeve të fëmijës nuk duhet të kufizohet vetëm në një moshë specifike, pasi kuptueshmëria dhe kapaciteti i fëmijës për të shprehur mendimin e tij nuk lidhet gjithnjë me moshën e tij.

► Të gjithë fëmijët kanë të drejtën të shprehin mendimet dhe tyre, dhe autoritetet duhet t'u japin kë-tyre mendimeve rëndësinë e duhur sipas moshës dhe pjekurisë së tyre.

Si pasojë, pjekuria e fëmijëve duhet të vlerësohet individualisht nga një psikolog ose nga punonjës socialë që kanë përvojë në punën me fëmijët. Ky vlerësim duhet të jetë informativ kur bëhet fjalë për përshtatjen e gjuhës për sigurimin e informacionit për fëmijët e pashoqëruar dhe për të verifikuar kuptueshmërinë e tyre. Përveç kësaj, për t'i ndihmuar fëmijët të shprehin mendimet e tyre, procedurat duhet të përshtaten.

## Procesi i vendimarrjes

Kur bëhet vlerësimi i bazës për aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë faktorëve të lartë të rrezikut ndaj të cilëve janë të ekspozuar fëmijët, si dhe formave të persekutimit ose dëmtimeve serioze që janë specifike për fëmijët (për shembull, rekrutimi nën moshë në forcat e armatosura, trafikimi i fëmijëve, shfrytëzimi seksual dhe/ose shkeljet e të drejtave të caktuara të fëmijës, dhe praktikat tradicionale të dëmshme).

Në fazën e përgatitjes, funksionari i çështjes duhet të konsultohet dhe të marrë njohuri të hollësishme për COI specifike për fëmijën.

Aty ku është e mundur, funksionari përgjegjës duhet të kërkojë në mënyrë aktive të marrë informacion nga burimet përkatëse për të vlerësuar siç duhet interesat më të mira të fëmijës në procedurën e azilit. Duke i kushtuar konsideratë mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit, dhe në përputhje me sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës, personat që kanë dijeni për situatën e fëmijës duhet të kontaktohen (si për shembull personat e besuar, kujdestari/përfaqësuesi, kujdestari aktual, punonjësit socialë në qendrën e pranimit, mësuesi, etj.).

Jo vetëm gjatë intervistimit, por edhe kur vlerësohen provat ose historia që tregon fëmija, funksionari i çështjes duhet të mbajë parasysh mënyrën se si komunikojnë fëmijët. Fëmijët nuk janë në gjendje t'i shpjegojnë gjërat në të njëjtën mënyrë si të rriturit. Ky kufizim është veçanërisht i dukshëm kur marrim parasysh ndikimin që kanë moshë dhe traumat e mundshme dhe/ose kushtet psikologjike të kujtesa dhe kapaciteti për të dhënë informacion të plotë dhe koherent, dhe si rrjedhojë të vlerësimi i besueshmërisë gjatë ekzaminimit. Si pasojë, autoritetet duhet të marrin përsipër një barrë më të madhe prove në rastet e fëmijëve, dhe sidomos në rastet e fëmijëve të pashoqëruar ose të rrezikuar. Përveç kësaj, kur shqyrtohet aplikimi i një fëmije, dobia e dyshimit aplikohet sa më gjerë të jetë e mundur, sidomos në rastin e fëmijëve të pashoqëruar të cilët ka më pakë të ngjarë të kenë prova të dokumentuara.

► Pasi të merret vendimi, autoritetet duhet të sigurohen që fëmijës t'i jepet një vendim i arsyetuar me shkrim për azilin (ku shpjgohet, ndër të tjera, si u jepet rëndësi parësore interesave më të mira të fëmijës), i shpjgohet me gojë në një mënyrë të përshtatshme për fëmijën dhe në një gjuhë që fëmija mund ta kuptojë.

Në rastin e një vendimi negativ, fëmijës dhe kujdestarit duhet t'i jepet informacion për rrugët alternative ligjore të mundshme (p.sh. autorizim për qëndrim ose banim të rregullt për shkak të moshës dhe/rrezikueshmërisë së tij), ose të paktën duhet të referohen te shërbimet e sigurimit të informacionit.

Në rastet ku nuk ekzistojnë disa prej masave mbrojtëse të përmendura më sipër, ekzaminimi i aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare mund të vihet në pritje. Kjo duhet të peshohet në varësi të natyrës së masave mbrojtëse që mungojnë.

## Mekanizmi kombëtar i referimit

Për fëmijët azilkërkues, përfshirja e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në mekanizmat e referimit është aktualisht i kufizuar dhe duhet përforcuar dhe siguruar. Të gjitha palët përkatëse në nivel qendror dhe lokal duhet të takohen rregullisht nëse nuk ekziston sistem për ndarjen e informacionit. Duhet të jetë gjithnjë e qartë se cili autoritet është përgjegjës për caktimin e një kujdestari/përfaqësuesi ose për dhënien e aksesit për procedurat më të përshtatshme për fëmijën, me qëllim që të shmangen boshllëqet e mbrojtjes për shkak se autoritetet e ndryshme që besojnë të tjerët janë përgjegjëse për aspekte të caktuara të çështjes së fëmijës.

► Sigurohu që autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve të përfshihen dhe që shqetësimet e identifikuar (si abuzimi, trauma, dhuna, nevojat e veçanta/rrezikueshmëria, problemet mjekësore, etj.) të grumbullohen, dokumentohen dhe komunikohen me autoritetet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Kur rreziqet ose rrezikshmëritë të jenë identifikuar, duhet të vihen garanci procedurale të veçanta. Përveç kësaj, fëmija duhet të referohet për ndihmë dhe/ose vlerësim të mëtejshëm brenda autoritetit të azilit, ose një ofruesi shërbimi ose autoriteti tjetër, si autoriteti i pranimit ose mbrojtjes së fëmijëve, për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës. Ky referim mund të jetë për konsultim profesional ose këshillim ligjor. Një shembull është referimi i viktimave të trafikimit te mekanizmat e duhur të referimit, duke siguruar komunikim të mbrojtjes ndërkombëtare dhe të sistemeve kundër trafikimit.

Për ata fëmijë me nevoja të veçanta, referimi për asistentë duhet të bëhet sipas nevojës, për shembull, për kujdes mjekësor ose psikologjik dhe për mbështetje ose ndihmë materiale, p.sh. për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nuk duhet të përfshihen konkluzione lidhur me diagnozën shëndetësore të fëmijës ose të aplikuesve shoqëruar, përveç nëse është bashkëngjitur një raport mjekësor.

Konsiderohet praktikë e mirë që asistencë të zgjatet përtej moshës 18 vjeç për të siguruar një periudhë tranzicioni deri në fitimin e pavarësisë së plotë në mënyrë graduale, sidomos në rastet e fëmijëve të pashoqëruar ose të fëmijëve që kanë nevojë për trajtim për të siguruar një rikuperim të plotë.

## Stafi i kualifikuar

Funksionarët e azilit që përfshihen me fëmijët duhet të jenë të kualifikuar, me eksperiencë për të punuar me fëmijët dhe të trajnuar siç duhet. Zyrtarët që merren direkt me fëmijën duhet të trajnohen për përdorimin e teknikave që janë të përshtatshme për fëmijët. Shtetet e BE+ duhet të caktojnë staf të trajnuar në mënyrë të veçantë për t'u marrë me çështjet e fëmijëve dhe për rritur vazhdimisht kapacitetin e stafit të tyre. Përkthyesit duhet të trajnohen gjithashtu dhe të njihen me praktikën e përkthimit për fëmijët.

► Vendimet lidhur me aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare duhet të merren nga një autoritet kompetent, i pajisur plotësisht me të gjitha instrumentet ligjore lidhur me të drejtat e fëmijëve, trafikimin dhe çështjet e tjera përkatëse për mbrojtjen.

Përveç trajnimit, është e rëndësishme që qëndrimi i funksionarit dhe i përkthyesit t'i japë mundësi fëmijës të ndihet lirshëm. Funksionari kompetent dhe përkthyesi duhet të jetë sa më i natyrshëm, proaktiv dhe të shfaqë empati.

## **Getting in touch with the EU**

### **In person**

All over the European Union there are hundreds of Europe Direct information centres. You can find the address of the centre nearest you at: <http://europa.eu/contact>

### **On the phone or by email**

Europe Direct is a service that answers your questions about the European Union. You can contact this service:

- by freephone: 00 800 6 7 8 9 10 11 (certain operators may charge for these calls),
- at the following standard number: +32 22999696 or
- by email via: <http://europa.eu/contact>

## **Finding information about the EU**

### **Online**

Information about the European Union in all the official languages of the EU is available on the Europa website at: <http://europa.eu>

### **EU publications**

You can download or order free and priced EU publications from EU Bookshop at: <http://publications.europa.eu/eu-bookshop>. Multiple copies of free publications may be obtained by contacting Europe Direct or your local information centre (see <http://europa.eu/contact>).

### **EU law and related documents**

For access to legal information from the EU, including all EU law since 1951 in all the official language versions, go to EUR-Lex at: <http://eur-lex.europa.eu>

### **Open data from the EU**

The EU Open Data Portal (<http://data.europa.eu/euodp>) provides access to datasets from the EU. Data can be downloaded and reused for free, both for commercial and non-commercial purposes.



Publications Office  
of the European Union